

## MARRËVESHJA E LIÇENSIMIT TË BLACKBERRY SOLUTION

**JENI TE LUTUR TE LEXONI KËTË DOKUMENT ME KUJDES PËRPARA INSTALIMIT APO PËRDORIMIT TË PROGRAMIT. KJO MARRËVESHJE PËRMBAN DISPOZITA TË CILAT KUFIZOJNË OSE PËRJASHTOJNË PËRGJEGJËSINË E RIM KUNDREJT JUSH DHE KA NDIKIM MBI TË DREJTAT TUAJA LIGJORE NË NDONJË MËNYRË TJETËR. NË VARËSI TË JURIDIKSIONIT TUAJ, KJO MARRËVESHJE MUNDËT GJITHASHTU T'JU KËRKOJË TË PËRDORNI ARBITRAZHIN NË BAZA INDIVIDUALE PËR TË ZGJIDHUR MOSMARRËVESHJET NË VËND TË GJYKIMEVE ME JURI OSE PADIVE TË PËRBASHKËTA. KJO MARRËVESHJE NUK PREK TË DREJTAT TUAJA LIGJORE TË DETYRUESHME TË ZBATUESHME NË JURIDIKSIONIN TUAJ, PËR AQ SA JU JENI TITULLAR I KËTYRE TË DREJTAVE LIGJORE TË DETYRUESHME.**

Kjo Marrëveshje e Liçensimit të BlackBerry Solution ("Marrëveshja") është një marrëveshje e ligjshme midis Jush: individualisht nëse ju e pranoni atë nën cilësinë tuaj personale, ose nëse jeni të autorizuar ta bleni Programin (siç përcaktohet më poshtë) në emër të shoqërisë tuaj ose të ndonjë enti tjetër, midis entit për llogari të të cilit ju veproni (në secilin rast, "Ju"), dhe Research In Motion UK Limited, me Nr. të Shoqërisë 4022422 ("RIM") zyra qendrore e së cilës është në 200 Bath Road, Slough, Berkshire, United Kingdom SL1 3XE ("Palët" së bashku dhe individualisht një "Palë"). Në kontekstin e shpërndarjes së Ofertave (siç përcaktohet më poshtë), RIM nënkupton Research In Motion E-Commerce S.a.r.l ose çdo filial tjetër të RIM i identifikuar si distributori i Ofertave në juridikSIONIN Tuaj në <http://www.BlackBerry.com/legal/rime> ("RIME"). Nëse jeni duke e përdorur Programin së bashku me një Produkt Handheld qoftë në cilësinë tuaj personale qoftë për llogari të shoqërisë suaj ose enti tjetër atëherë "Ju" nënkupton ju në cilësinë tuaj personale për disa nga artikujt e Programit dhe Shërbimet e RIM, dhe do të nënkuptojë entin për llogari të të cilit ju jeni duke vepruar për Programin tjetër dhe Shërbimet e RIM (p.sh. nëse shoqëria për të cilën ju punoni ju ka autorizuar të lidhni këtë Marrëveshje në lidhje me përdorimin tuaj të llogarisë së emailit të Serverit BlackBerry Enterprise("BES") dhe aplikacionet e menaxhimit të informacionit personal BlackBerry ("PIM Applications"), por nuk autorizon dhe nuk merr përgjegjësi për përdorimin tuaj të programit ose shërbimeve, të tilla si Programi i klientit Windows Live Messenger ose një Magazinë RIME, atëherë "Ju" nënkupton shoqërinë tuaj për llogarinë e emailit BES dhe Aplikacionet PIM, dhe "Ju" nënkupton juve personalisht në lidhje me përdorimin tuaj të Programit të klientit Windows Live Messenger dhe Magazinës RIME). Për sa i përket liçensës dhe shpërndarjes së Programit RIM është qoftë në mënyrë direkte ose indirekte i liçensuar nga: (a) Research in Motion Limited ("RIM Canada") ose çdo një ose më shumë prej shoqërive të kontrolluara dhe filialeve të saj (shoqëritë e kontrolluara dhe filialet së bashku me RIM Canada referohen në këtë Marrëveshje si "Shoqëritë e Grupit RIM"); ose (b) një liçensues i palës së tretë të ndonjë prej Shoqërive të Grupit RIM duke përfshirë dhe RIM.

DUKE KLIKUAR NË BUTONIN E DUHUR MË POSHTË, OSE DUKE INSTALUAR, AKTIVIZUAR OSE DUKE PËRDORUR PROGRAMIN, JU PRANONI TË RESPEKTONI KUSHTET DHE AFATET E KËSAJ MARRËVESHJEJE. NËSE KENI NDONJË PYETJE APO SHQETËSIM NË LIDHJE ME KUSHTET E KËSAJ MARRËVESHJEJE, JENI TE LUTUR TE KONTAKTONI ME RIM NË [LEGALINFO@RIM.COM](mailto:LEGALINFO@RIM.COM).

KJO MARRËVESHJE ZËVENDESON DHE NXJERR JASHTË PËRDORIMIT ÇDO MARRËVESHJE TË MËPARSHME EKZISTUESE TË LIÇENSËS SË KONSUMATORIT TË PROGRAMIT BLACKBERRY DHE MARRËVESHJET E LICENSIMIT TË PROGRAMIT TË SERVERIT BLACKBERRY ENTERPRISE DHE ÇDO MARRËVESHJE TË LICENSIMIT TË PROGRAMIT BLACKBERRY OSE MARRËVESHJE TË LIÇENSIMIT BLACKBERRY SOLUTION, PËR AQ SA MARRËVESHJE TË TILLA JANË TË ZBATUESHME NDRYSHE, QË NGA DATA E PRANIMIT TUAJ TË KUSHTEVE TË KËSAJ MARRËVESHJE, TË ÇDO PROGRAMI QË ËSHTË PJESË E

BLACKBERRY SOLUTION TUAJ (PËR INFORMACION TË MËTEJSHËM, SHIH MË POSHTË SEKSIONIN ME TITULL "BASHKIMI I MARRËVESHJEVE" (SEKSIONI 30)).

### Kthimi

NËSE, PERPARA MOMENTIT TË PARË QË JU DO TË INSTALONI, AKTIVIZONI OSE PERDORNI ARTIKULLIN E PARË TË PROGRAMIT TË LICENSUAR SIPAS KËSAJ MARRËVESHJEJE, JU VENDOSNI SE NUK KENI DESHIRE TË PRANONI KUSHTET E KËSAJ MARRËVESHJEJE, JU NUK KENI TË DREJTË TË PERDORNI NDONJË PROGRAM DHE JU DUHET QË: (A) TA KTHENI MENJËHERË PROGRAMIN TEK RIM, TA FSHINI, OSE TA ÇAKTIVIZONI ATË; (B) NËSE KENI BLERË NJË PRODUKT TË RIM NË TË CILIN PROGRAMI ËSHTË INSTALUAR MË PARË NGA OSE NË EMËR TË RIM, KTHEJENI MENJËHERË PRODUKTIN E RIM DHE PROGRAMIN DHE ARTIKUJT SHOQËRUES (DUKE PËRFSHIRË DOKUMENTACIONIN DHE PAKETIMIN) TEK RIM OSE TEK DISTRIBUTORI I AUTORIZUAR PREJ TË CILIT JU MORËT PRODUKTIN E RIM DHE PROGRAMIN DHE ARTIKUJT SHOQËRUES; OSE (C) NË SE JU KENI BLERË NJË PRODUKT HANDHELD NGA NJË PALË E TRETË NË TË CILIN PROGRAMI ËSHTË INSTALUAR MË PARË NGA RIM OSE NË EMER TË RIM, MERRNI MASAT MENJËHERË PËR ÇAKTIVIZIMIN E PROGRAMIT ME RIM OSE ME DISTRIBUTORIN E AUTORIZUAR TË RIM, PREJ TË CILIT JU PËRFITUAT PRODUKTIN HANDHELD TË PALËS SË TRETË DHE PROGRAMIN DHE ARTIKUJT SHOQËRUES. Nëse, në rrethanat e përcaktuara më lart, Ju keni paguar për Programin, dhe/ose për Produktin RIM që Ju morët me këtë Program dhe nuk jeni në gjendje ta përdorni Produktin RIM pa atë Program, dhe Ju ia jepni RIM ose distributorit të autorizuar prej të cilit Ju morët Programin për Produktet e RIM me vërtetimin e blerjes tuaj brenda tridhjetë (30) ditëve nga data që Ju morët programin, RIM ose distributori i autorizuar do t'ju kthejë Juve paratë (nëse ka) që keni paguar për këto artikuj. Për tu rimbursuar për Programin në Produkte të Palëve të Treta (vini re se sidoqoftë Programi i disa Produkteve Handheld të Palës së Tretë jepet pa pagesë dhe si rrjedhojë mund të mos keni asgjë për rimbursim) jeni te lutur te kontaktoni distributorin Tuaj të autorizuar të Programit për atë Produkt Handheld të Palës së Tretë. Nëse, në rrethanat e përcaktuara më lart, Ju nuk jeni në gjendje të merrni paratë për Programin nga një distributor i autorizuar, jeni te lutur te kontaktoni RIM në [legalinfo@rim.com](mailto:legalinfo@rim.com).

1. Përkufizime. Përveç kur përmbajtja e kërkon ndryshe, termat në vijim do të kenë kuptimet e përcaktuara më poshtë (dhe ku përmbajtja e lejon, njëjësi do të përfshijë shumësin dhe anasjelltas).

"Shërbimi Airtime" nënkupton shërbimin e rrjetit pa kabëll të një zone të gjerë, shërbime të tjera të rrjetit (duke përfshirë rrjetin lokal pa kabëll, shërbimet satelitore dhe të Internetit) dhe çdo shërbim tjetër të ofruar nga Ofruesi(t) i(e) Shërbimit Airtime për përdorim në lidhje me BlackBerry Solution Tuaj.

"Ofrues i Shërbimit Airtime" nënkupton një ent që ofron Shërbimet Airtime.

"Përdoruesit e Autorizuar" nënkupton secilin nga sa me poshtë të cilëve, Ju i lejoni të përdorin Programin si pjesë e BlackBerry Solution Tuaj: (a) cilido prej punonjësve Tuaj, konsulentët apo kontraktuesit e pavarur; (b) ndonjë mik apo anëtar i familjes, ose çdo person që jeton në ambientin Tuaj; dhe (c) çdo person tjetër të cilin RIM e autorizon me shkrim. Pavarësisht sa më sipër, kjo Marrëveshje nuk mbart të drejtën automatike që Programi Juaj i Serverit BlackBerry të pritët nga një palë e tretë. Nëse Ju dëshironi të veproni kështu, jeni te lutur te kontaktoni RIM në: [legalinfo@rim.com](mailto:legalinfo@rim.com).

"Produkti Handheld BlackBerry", i njohur gjithashtu si "BlackBerry Devices", do të thotë një pajisje e prodhuar nga ose për llogari të RIM, duke përfshirë çdo smartphone të tillë, lexues karte smart, tablet, ose BlackBerry Presenter dhe çdo pajisje tjetër të identifikuar qartë nga RIM në [http://www.BlackBerry.com/legal/BlackBerrydevices\\_for\\_bbsla](http://www.BlackBerry.com/legal/BlackBerrydevices_for_bbsla) si një Produkt BlackBerry Handheld.

"Programi Handheld BlackBerry" nënkupton një Program që ka në pronësi RIM (të përfshirë në pronësinë e RIM: program, set instruksionesh të programuara, ndërfaqet dhe Përmbajtje nëse konsiderohen ose jo teknikisht kode të programit; dhe Komponentët e Palës së Tretë), ose ndonjë pjesë të saj, e projektuar për përdorim në Produktin Handheld që është : (a) i ngarkuar në Produktin Handheld në mënyrë origjinale ashtu siç është transportuar nga RIM; ose (b) e transmetuar, e shpërndarë ose që ju është vënë në dispozicion here pas here, apo në një mënyrë tjetër, nga apo në emër të RIM për t'u përdorur në Produktin Tuaj Handheld qoftë drejtpërdrejt ose nëpërmjet Magazinës RIME. Modele të Programit BlackBerry Handheld përfshijnë programin sistemin kompjuterik operativ dhe aplikacionet të para-instaluar në një Produkt Handheld BlackBerry në pronësi të RIM, ose të mundësuar nëpërmjet Magazinës RIME, ose çdoprodukt programi në pronësi të RIM të transmetuar, të shpërndarë ose që ju është vënë në dispozicion në një mënyrë tjetër nga apo në emër të RIM herë pas here, specifikisht për t'u përdorur në Produktet Handheld të Palës së Tretë.

"Shërbimet e Pagesës BlackBerry " është infrastruktura e pagese në pronësi të RIM e cila mundëson blerjen e Produkteve In-App dhe produkte dhe shërbime të tjera dixhitale nëpërmjet një Magazine RIME.

"Program i Kompjuterit Personal BlackBerry" nënkupton Program që ka në pronësi RIM (të përbërë nga programi në pronësinë të RIM, ndërfaqet dhe Përmbajtja, nëse konsiderohen ose jo teknikisht kode të programit; dhe Komponentët e Palës së Tretë), ose ndonjë pjesë të saj, e projektuar për përdorim si pjesë e BlackBerry Solution për një konsumator të vetëm për ta përdorur dhe për të hyrë në një kompjuter personal në çdo kohe. Një model i Programit të Kompjuterit Personal BlackBerry është "Programi BlackBerry i Desktop-it", i cili mund të përdoret për sigurimin dhe për ruajtjen e sinkronizimit ndërmjet Produktit Tuaj Handheld dhe kompjuterit Tuaj personal dhe siguron funksionalitete të tjera të organizimit të desktopit.

"Shërbimet Prosumer BlackBerry" janë shërbime të RIM të projektuara dhe të ofruara nga RIM për të pajisur klientelën e RIM me disa funksione të caktuara, të ofruara nga Programi i Serverit BlackBerry pa qënë e nevojshme që klientët e RIM të blejnë këtë program serveri. Një shembull i Shërbimeve Prosumer BlackBerry është "Shërbimi i Interneti BlackBerry" të RIM, i cili i mundëson të abonentëve që: (a) të integrojnë një ISP të caktuar ose llogari të tjera e-maili të palëve të treta, për dërgesa të bazuara në "mekanizmin e ardhjes" në Produktin Tuaj Handheld; (b) të krijojnë një adresë e-mail të bazuar në një pajisje për Produktin Tuaj Handheld; dhe (c) akses në disa përmbajtje dhe shërbime të caktuara në Internet. Të gjitha ose disa nga Shërbimet Prosumer BlackBerry mund të mos përballohen nga Furnizuesi i Shërbimit Tuaj Airtime. Jeni te lutur te kontrolloni me Furnizuesin e Shërbimit Tuaj Airtime për disponibilitet.

"Programi i Serverit BlackBerry" nënkupton një Program server që ka në pronësi RIM (të përbërë në pronësinë e RIM: programi, ndërfaqet dhe Përbërja, që mund ose jo të konsiderohen teknikisht kode programi, duke përfshirë pa kufizim identifikuesin e protokollit të kursit të serverit (SRP ID), çelesin e autenticitetit të SRP-së dhe çdo identifikues tjetër që RIM ofron për përdorim me një kopje të veçantë të programit të serverit; dhe Komponentët e Palës së Tretë) ose ndonjë pjesë të saj, një kopje e vetme e së ciles është projektuar që të instalohet në një kompjuter dhe të ketë akses nga një sërë Produktesh Handheld apo kompjutera personal, ashtu siç aplikohet, në të njëjtën kohë. Modele të Programit të Serverit BlackBerry përfshijnë produktin "Serverin BlackBerry Enterprise", i cili është projektuar për tu integruar dhe për të siguruar një lidhje ndërmjet serverave që aplikojnë së bashku (siç janë serverat e e-

mail-it) dhe Produktet Handheld të pajisur për të operuar me programin "BlackBerry Enterprise Server" dhe programin "BlackBerry Mobile Voice", i cili është projektuar që të bjëe karakteristikat e telefonit të zyrës të mundura për Produktet Handheld.

"BlackBerry Solution" nënkupton nje Program, dhe të paktën një nga artikujt e mëposhtme shtesë për përdorim në lidhje me Programin: Produkti RIM, Programi i Serverit BlackBerry, Programi BlackBerry Handheld, Program kompjuterik personal BlackBerry dhe/ose të Shërbimit(ve); së bashku me Documentacionin e aplikueshëm.

"Përmbajtje" nënkupton çdo të dhënë, tekst, muzik, tingull, zile telefoni, fotografi, grafik, video, mesazh, etiketë ose material të tjera dixhitale ose informacion tjetër dixhital.

"Dokumentacion" nënkupton guidën e zbatueshme e instalimit ose dokumentacioni standart i përdoruesit fundor, duke përfshirë çdokod sjellje, udhëzim ose rregullat e përdorimit të përgatitur dhe i furnizuar nga RIM për llojin dhe versionin e veçantë të Programit, Produktit RIM ose Shërbimit të RIM, duke përfshirë dhe udhëzimet e sigurisë. Dokumentacioni i përdoruesit fundor dhe administratorit është gjithashtu i disponueshëm në <http://docs.BlackBerry.com> ose duke kontaktuar RIM në [legalinfo@rim.com](mailto:legalinfo@rim.com). Për tq qartësuar, Dokumentacioni nuk përfshin ndonjë guidë të instalimit ose dokumentacion të përdoruesit fundor që është i përgatitur nga ndonjë person, i ndryshëm nga RIM ose çdondryshim e bërë dokumentacionit nga ndonjë person, i ndryshëm nga RIM.

"Produkt Handheld" nënkupton: (a) një Produkt BlackBerry Handheld; ose (b) një Produkt Handheld i Palës së tretë.

"Produkte In-App" nënkupton produktet ose shërbimet dixhitale që u janë shitur Juve duke përdorur Shërbimin e Pagesës BlackBerry nëpërmjet kopjeve të Programit ose Programit të Palës së Tretë që ju blini nëpërmjet një Magazine RIME.

"Kiosk" nënkupton një department në një Magazinë RIME.

"Tregtari i Regjistrimit" ose "MoR" nënkupton entin i cili është përgjegjës për përpunimin e blerjeve siç identifikohet në kohën e blerjes, i cili mund të ndryshojë nga lloji i pagesës, juridiksioni dhe Kioska-a.

"Bota Ime" nënkupton një magazinë që ju mundëson Ju të çinstaloni dhe ri-instaloni në produktin Tuaj Handheld një program të caktuar dhe Artikuj të Palës së Tretë të cilat Ju i bleni nëpërmjet një Magazine RIME.

"Ofertat" nënkupton Produktet In-App, dhe çdoartikull ose shërbim të mundësuar nëpërmjet një Magazine RIME duke përfshirë, çdoProdukt RIM, Program, Shërbim i RIM, Artikull i Palës së Tretë ose Shërbim i Palës së Tretë të mundësuar në këtë mënyrë.

"Shitësit e Ofertave" nënkupton individët dhe entet që paraqesin Ofertat për shpërndarje nëpërmjet një magazine RIME.

"Shërbimet e paguara të RIM " nënkupton Shërbimet e RIM për të cilat Ju ose Përdoruesit Tuaj të Autorizuar duhet të regjistroheni dhe t'i paguani një tarifë RIM për t'i përfituar.

"Periferiket e RIM" nënkupton aksesoret e ose artikujt e tjerë të markës RIM duke përfshirë, karta memorie microSD apo memorie të tjera të zgjerueshme dhe kufje të projektuara për të punuar në lidhje me një Produkt RIM.

"Produkt RIM" nënkupton çdonjërin prej Produkteve BlackBerry Handheld dhe çdo Periferik të RIM pa përfshirë ndonjë Program.

"Shërbimi (et) i(e) RIM " nënkupton çdo shërbim të identifikuar shprehimisht si një shërbim i mundësuar Juve nga ose në emër të RIM ose një filiali të RIM, duke përfshirë shërbimet e tilla të identifikuar nga RIM në <http://www.BlackBerry.com/legal/rimservices> si një Shërbim i RIM; por fakti që RIM bashkëvendos markën një Shërbimi të Palës së Tretë nuk e bën atë në vetvete një Shërbim të RIM.

"Magazina RIME" nënkupton një vitrinë dixhitale në pronësi të RIME ose filiali të RIME, përveç "BlackBerry Enterprise Store", nëpërmjet së cilës Shitësit e Ofertave paraqesin Ofertat për shpërndarje tek përdoruesit fundor; por për të qënë të qartë "Magazina RIME" nuk përfshin vitrinën dixhitale në [www.shopBlackBerry.com](http://www.shopBlackBerry.com) e punuar nga Global Solutions, Inc.

"Oferta e Magazinës RIME" nënkupton një Ofertë të mundësuar nëpërmjet një Magazine RIME.

"Ofruesit e Shërbimit" ka kuptimin të përcaktuar në Seksionin 9(e).

"Program" nënkupton çdonjërin prej Programeve BlackBerry Handheld, Programeve të kompjuterit personal BlackBerry apo Programi i Serverit BlackBerry të cilët ju janë dhënë Juve në bazë të kësaj Marrëveshje, në çfarëdo forme, mjeti apo mënyre të siguruar, të instaluar ose të përdorur më pas. Termi "Program" nuk do të përfshijë ndonjë Program të Palës së Tretë ose Artikull të Palës së Tretë, edhe nëse ky Program i Palës së Tretë ose Artikull e Palës së Tretë është shpërndarë nga RIM ose në emër të RIM, ose nëpërmjet një Magazine RIME ose ndonjë kanal tjetër që përdor Shërbimet e Pagesës BlackBerry, ose Programi i Palës se Tretë ose Artikulli i Palës së Tretë të shoqëruar, është i pajisur, apo operon në lidhje me, Programin dhe/ose ndonjë pjesë tjetër të Tuajit BlackBerry Solution apo të Produktit Handheld të Palës së Tretë.

"Përbërësit e Palës së Tretë" nënkupton programet dhe ndërfaqet, e liçensuara nga RIM nga një palë e tretë për përfshirjen në një produkt të programit të RIM, ose që do të përfshihen në firmëare në rastin e produkteve hardware të RIM, dhe të shpërndarë si një pjesë integrale e atij produkti të RIM nën markën e RIM, por nuk do të përfshijë Programin e Palës së Tretë.

"Përmbajtja e Palës së Tretë" nënkupton Përmbajtjen në pronësi të një Pale të Tretë.

"Produkt Handheld i Palës së Tretë" nënkupton çdo pajisje duke përfshirë një pajisje të lëvizshme të tillë si smartphone ose tabletë, përveç BlackBerry Device, në të cilën Programi BlackBerry Handheld ose ndonjë pjesë e tij, është projektuar ose autorizuar nga RIM të punojë (duke përfshirë, ku Programi BlackBerry Handheld ka për qëllim të aksesojë infrastrukturën e RIM, lidhjen nga RIM të një marrëveshje me Ofruesin Tuaj të Shërbimit Airtime duke autorizuar atë pajisje të palës së tretë të ketë akses në infrastrukturën e RIM).

"Artikujt e Palës së Tretë" nënkuptojnë Përmbajtjen e Palës së Tretë dhe Produktet e Palës së Tretë.

"Hardwaret e Palës se Tretë" nënkupton Produktet Handheld, kompjuter, pajisje, periferikë dhe çdo produkt tjetër hardware që nuk është një Produkt i RIM.

"Produktet e Palës së Tretë" nënkupton Hardware i Palës së Tretë dhe Program i Palës së Tretë dhe të gjitha produktet e tjera tregtare që nuk janë Produkte të RIM.

"Shërbimet e Palës së Tretë" nënkupton shërbimet e siguruar nga një palë e tretë, duke përfshirë Shërbimin Airtime, shërbimet e siguruar nga një palë e tretë MoR ose procesues pagese, dhe çdo faqe interneti që nuk operohet nga RIM.

"Programet e Palës së Tretë" nënkupton aplikimet e pavarura të programit në pronësi të palës së tretë që janë ofruar ose përndryshe që janë vënë në dispozicion nga, në ose ndërmjet Produkteve RIM, Shërbimeve ose Programeit të RIM. Të tilla si Magazina RIME.

"BlackBerry Solution Juaj" nënkupton Programin, dhe të paktën një prej artikujve shtesë të mëposhtme të cilat Ju i merrni, i instaloni, i aktivizoni, ose përndryshe i autorizoni dhe pranoni përgjegjësinë për përdorimin, në lidhje me Programin, siç zbatohet në rrethanat Tuaja: Produkti i RIM, Programi i Serverit BlackBerry, Programi BlackBerry Handheld, Programi i kompjuterit personal BlackBerry dhe/ose Shërbimi(et); së bashku me Dokumentacionin përkatës. Artikujt e Palës së Tretë dhe Shërbimet e Palës së Tretë nuk janë pjesë e Tuajit BlackBerry Solution.

"Përmbajtja Juaj" nënkupton çdo Përmbajtje që Ju ose Përdoruesit Tuaj të Autorizuar i paraqisni ose i vini në dispozicion në ndonjë mënyrë tjetër një Shërbimi RIM ose shërbim të Palës së Tretë.

2. Liçenca e Programit dhe Dokumentacionit. Programi sipas kësaj Marrëveshjeje është i liçensuar dhe nuk shitet. Liçenca Juaj për të përdorur Programin është e kushtëzuar nga pagesa e tarifave të liçensës, nëse ka. Duke iu përmbajtur kushteve dhe afateve të saj, kjo Marrëveshje iu jep Juve një liçensë personale, të revokueshme, jo-ekskluzive, të pa transferueshme që iu lejon Juve dhe Përdoruesve Tuaj të Autorizuar, së bashku:

- (a) nëse Programi është Program i Serverit BlackBerry:
  - (i) të instaloni dhe të përdorni numrat e kopjeve (duke përfshirë dhe kopjet virtuale) të Programit për të cilin komisionet e liçensimit i janë paguar RIM ose distri distributorit të autorizuar të RIM për Programin (dhe nëse nuk ka tarifa të pagueshme për Programin e RIM apo te distributorit të autorizuar të RIM, atëherë të instaloni dhe përdorni numrat e kopjeve vetëm me autorizimin me shkrim të RIM ose të distributorit të autorizuar të RIM); dhe
  - (ii) të mundësoni aksesin deri në numrin e Produkteve Handled ose kompjuterave personale, sipas rastit, për shembull numri i licensave të aksesit për klientët ("CALs") të blera për Programin e "Serverit BlackBerry Enterprise") për të aksesuar Programin (dhe nëse asnjë pagesë nuk i është bërë RIM ose distributorit të autorizuar të RIM për të mundësuar aksesimin e Programit Handheld Products, atëherë të lejojë deri në numrin e Produkteve të Dorës ose kompjuterat personale ose me autorizim me shkrim nga RIM ose distributori i autorizuar i tij); dhe
- (b) nëse Programi është Program BlackBerry Handheld apo Program i Kompjuterit personal BlackBerry dhe:
  - (i) është instaluar më parë në hardware, atëherë përdorni kopjen e vetme të atij Programi të instaluar në hardware; ose
  - (ii) nuk është instaluar më parë në hardware, atëherë, për të instaluar dhe përdorur Programin, mbi numrin e njërive të hardwareve të aplikueshëm që i korrespondojnë tarifave që i janë paguar RIM apo distributorit të autorizuar të RIM (dhe nëse asnjë pagesë nuk i paguhet RIM apo distributorit të autorizuar të RIM për Programin,

atëherë instaloni dhe përdorni numrin e kopjeve vetëm me autorizimin me shkrim nga RIM ose nga distributori i autorizuar i RIM).

Nëse Jeni duke blerë Programin (dhe ndonjë CALs në lidhje me të) në baza abonimi ose si pjesë e një përdorimi falas, atëherë të drejtat e licënsimit të përcaktuara më sipër, zbatohen vetëm për periudhën e kohës për të cilën ju keni paguar tarifen e abonimit të nevojshëm ose për periudhën e autorizuar nga RIM apo shpërndarësi i tij i autorizuar, sipas rastit).

Në të gjitha rastet, licënsa(t) e dhëna sipas kësaj Marrëveshjeje, iu lejojnë Juve dhe Përdoruesve Tuaj të Autorizuar të përdorni ose të lejoni përdorimin e Programit ose për të patur akses në Shërbimet e RIM vetëm për përdorimin Tuaj të brendshëm dhe për qëllime personale dhe vetëm si pjesë e BlackBerry Solution Tuaj. Nëse një Përdorues i Autorizuar dëshiron gjithashtu të përdorë Programin Handheld BlackBerry, si pjesë e një BlackBerry Solution tjetër (p.sh. një BlackBerry Solution i përbërë nga pjesë të produkteve që ka në pronësi RIM, programe apo shërbime të cilat Ju, apo dikush që vepron në emrin Tuaj, nuk i keni marrë, instaluar ose parashikuar, dhe që Ju jeni të gatshëm për t'i lejuar, por nuk pranoni përgjegjësi, për një përdorim të tillë; "BlackBerry Solution të tjera"), atëherë ai përdorim nuk mbulohet nga kjo marrëveshje licënsimi dhe Ju duhet t'i kërkonte Përdoruesit të Autorizuar të lidhë veçmas një marrëveshje licënsimi me RIM, e cila i jep të drejtën atij ose asaj të përdorë Programin Handheld BlackBerry si pjesë e BlackBerry Solution Tjetër. Për shembull nëse Ju jeni një korporatë dhe punonjësi Juaj dëshiron të përdorë Programin BlackBerry Handheld së bashku me shërbimet BlackBerry Prosumer personale të tij ose të saj dhe Ju jeni të gatshëm t'ia lejoni, por jo të mbani përgjegjësi për këtë përdorim, atëherë ai përdorim nuk do të mbulohet nga kjo Marrëveshje me "Ju" dhe Ju nuk mbani përgjegjësi për të, vetëm në rast se Ju keni konfirmuar me Përdoruesin e Autorizuar se ai ose ajo kanë lidhur këtë Marrëveshje në cilësinë e tyre personale në lidhje me përdorimin e tyre të atij Programi si pjesë e BlackBerry Solution Tjetër. Në mënyrë të ngjashme nëse Ju keni një Marrëveshje Aksesit BES Hosted, konsumatorët Tuaj duhet të lidhin një Marrëveshje BBSLA në mënyrë që të përdorin Programin Enterprise Server BlackBerry si pjesë e BlackBerry Solution së tyre).

Azhornime dhe Përmirësime. Kjo Marrëveshje dhe licënsat e dhëna këtu nuk përfshijnë ndonjë të drejtë: (a) mbi përmirësime apo azhornime të pritshme të Programit apo të Programit të Palës së Tretë; (b) në rastin e Programit BlackBerry Handheld në një Produkt Handheld, mbi mundësinë për të patur akses mbi aplikimet, përveç atyre të përfshira në Program; ose (c) për të përfituar ndonjë Shërbim të ri apo të modifikuar të RIM. Pavarësisht sa më sipër, Programi mund të përfshijë funksionalitetin për të kontrolluar automatikisht për azhornime apo përmirësime në Program dhe Juve mund t'ju kërkohe të azhornoni Programin apo Programin e Palës së Tretë me qëllim për të vazhduar aksesin ose përdorimin e Shërbimeve të caktuara të RIM, të Programeve të tjera të reja ose Artikujve të Palës së Tretë ose të Shërbimeve të Palës së Tretë ose pjesë të saj. Përveç kur Ju, apo një palë e tretë me të cilën Ju keni lidhur një marrëveshje për sigurimin e BlackBerry Solution Tuajit ose pjesëve të tij, konfiguroni BlackBerry Solution Tuajin për të penguar transmetimin apo përdorimin e përmirësimeve apo azhornimeve në Program, Programe apo Shërbime të Palës së Tretë ose Shërbime të RIM, Ju në këtë mënyrë pranoni se RIM mund t'ju (por nuk është i detyruar) mundësojë këto përmirësime apo azhornime herë-pas-herë. Çdo azhornim ose përmirësim që ju mundësohet Ju nga RIM sipas kësaj Marrëveshjeje do të quhet Programi BlackBerry Handheld, BlackBerry PC Software, BlackBerry Server Software, Shërbimet e RIM ose Programe të Palës së Tretë, sipas rastit.

Produktet BETA. Nëse Programi, ose ndonjë Shërbim tjetër i aksesuar nëpërmjet Programit, identifikohet si vlerësim para-reklamimi programet "alfa" ose "beta" ("Programi Beta" dhe "Shërbimi Beta" përkatësisht), të drejtat e licënsimit të paraqitura më sipër në lidhje me përdorimin Tuaj të Programit Beta ose të aksesimit të Shërbimeve Beta, gjejnë zbatim vetëm për periudhën kohore të autorizuar nga RIM ("Periudhë Testimi") dhe vetëm për aq sa është e nevojshme për t'ju lejuar Ju dhe Përdoruesve Tuaj të



Autorizuar (nuk ka Përdorues të Autorizuar për Programin Beta ose për Shërbimet Beta nëse Ju jeni individ) për të testuar dhe për t'i dhënë fidbek RIM në lidhje me Programin Beta dhe Shërbimet Beta dhe ndonjë Produkti të RIM që ofrohet nga RIM për përdorim me Programin Beta ("Beta Hardware" dhe bashkë me Programin Beta dhe Shërbimet Beta, "Produktet Beta"); dhe nëse Programi Beta ose ndonjë Produkt tjetër Beta ofrohen si pjesë e programit të zhvillimit të RIM, për të zhvilluar programet e aplikimit vetëm për përdorimet me Programet e aplikueshme, ose për versionet komerciale të Programit Beta ose të Produkteve të tjera Beta, nëse dhe kur ata të lëshohen komercialisht nga RIM. Kjo licensë do të përfundojë automatikisht me mbarimin e Periudhës së Testimit, periudhë e cila mund të zgjatet ose të ndërpritet nga RIM në çdo kohë, në lirinë e tij, por, vetëm nëse Ju jeni në shkelje të kësaj Marrëveshjeje, RIM, nëse është e realizueshme, do të përdorë përpjekje komercialisht të arsyeshme për t'ju njoftuar Ju paraprakisht mbi çdo ndryshim lidhur me kohëzgjatjen e Periudhës së Testimit. Pavarësisht nga Periudha e Testimit, Ju pranoni dhe bini dakord se RIM mund të përfshijë masat teknike në Produktet Beta të cilat i bëjnë ato të paoperueshme pas një periudhe kohore specifike dhe Ju pranoni se Ju nuk do t'i shmangeni këtyre masave teknike dhe as do të përpiqeni për ta bërë këtë. Duke patur parasysh dhënien e licensës për Produktet Beta, Ju pranoni se Ju do t'i jepni RIM një Fidbek mbi Produktet Beta sipas kërkesës së arsyeshme të RIM, duke përfshirë fidbekun e vazhdueshëm në lidhje me përgjimet dhe gabimet e hasura gjatë Periudhës së Testimit, pa ndonjë kompensim apo rimbursim të çdo lloji nga RIM dhe se Paragrafi i mëposhtëm i quajtur "Fidbeku" do të gjejë zbatim në këtë Fidbek. RIM në mënyrë specifike mund t'ju kërkojë që Ju të plotësoni një raport në lidhje me një Produkt Specifik Beta dhe Ju pranoni të plotësoni raporte të tilla.

Të drejtat e Riprodhimit. Ju nuk mund të shpërndani ose të modifikoni Programin, ose ndonjë Përmbajtje që iu mundësohet Juve si pjesë e një Shërbimi RIM, në tërësi apo pjesërisht. Përveç për aq sa RIM i është kufizuar me ligj të ndalojë këto aktivitete, Ju nuk mund të kopjoni, riprodhoni ose në mënyra të tjera të publikoni Programin, ose ndonjë Përmbajtje të tij që iu mundësohet Juve si pjesë e një Shërbimi RIM, në tërësi apo pjesërisht, përveç nëse është autorizuar në këtë Marrëveshje ose në një Dokumentacion për zbatimin e Shërbimit të RIM, ose në një marrëveshje të vecantë me shkrim ndërmjet Jush dhe RIM ose një filiali të RIM. Për qëllimet e kësaj dispozite "kopjimi" apo "riprodhimi" nuk do të përfshijnë kopjimin e deklarimeve dhe udhëzimeve të Programit që ndodhin gjatë ekzekutimit normal të programit kur përdoret në përputhje me apo për qëllime të përshkruara në Dokumentacion, ose gjatë procesit të bërjes së kopjeve të rregullta rezervë të pa modifikuara të Programit ose të kompjuterit ose të sistemit në të cilin është instaluar Programi, në përputhje me praktikatat standarde të industrisë së biznesit. Ju nuk mund të kopjoni ndonjë Dokumentacion apo pjesë të tij përveçse për qëllimet Tuaja personale ose për përdorim të brendshëm dhe për përdorim në lidhje me përdorimin e BlackBerry Solution Tuaj.

3. Rregullat e Përdorimit të BlackBerry Solution. Ju jeni përgjegjës për të gjitha veprimet në lidhje me BlackBerry Solution Tuajin, të ndërmarra nga Ju dhe Përdoruesit Tuaj të Autorizuar dhe Ju duhet të siguroni se:

- (a) Ju dhe Përdoruesit Tuaj të Autorizuar, do të përdorni BlackBerry Solution Tuaj dhe ndonjë pjesë të tij, në përputhje me këtë Marrëveshje, me të gjitha ligjet e aplikueshme dhe rregulloret, dhe Dokumentacionin përkatës për BlackBerry Solution Tuajin dhe të ndonjë pjesë të tij;
- (b) Ju keni të drejtën dhe autoritetin të lidhni këtë Marrëveshje, qoftë në emrin Tuaj apo në emër të një kompanie apo enti tjetër dhe Ju keni mbushur moshën madhore;
- (c) Çdo informacion që i sigurohet RIM sipas kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë regjistrimin për të përdorur Shërbimet RIM, vendosjen e një rendi me anë të një Magazine RIME, ose duke kryer një tranaksion përmes Shërbimit të Pagesave BlackBerry, është i vërtetë, i saktë,



aktual dhe i plotë dhe për aq sa Ju ose Përdoruesit Tuaj të Autorizuar vazhdoni të përdorni Shërbimin RIM ose mbani një llogari, Ju duhet të përditësoni këtë informacion, të ruani vërtetësinë, saktësinë dhe plotësinë e tij;

- (d) Ju dhe Përdoruesit Tuaj të Autorizuar në mënyrë të vetëdijshme nuk do të merrni përsipër, pasi të keni bërë këto kërkitime si person i arsyeshëm në cilësinë Tuaj apo të Përdoruesit Tuaj të Autorizuar, që të përdorni ose të lejoni të tjerët të përdorin BlackBerry Solution Tuaj, apo pjesë të tij, vetëm ose në kombinim me ndonjë Artikull të Palës së Tretë ose Shërbime të Palës së Tretë, në një mënyrë që sipas gjykimit të arsyeshëm të RIM, interferojnë, prishin apo ndikojnë negativisht në Program, sistem, hardware, rrjet, Përmbajtje, ose shërbim, duke përfshirë çdo pjesë të BlackBerry Solution Tuaj, apo të ndonjë Përdoruesi tjetër Fundor, që përdoret nga ndonjë person duke përfshirë RIM apo një Ofrues të Shërbimit Airtime ose të tjerë, ka një efekt shkatërrues mbi RIM dhe Grupin e Shoqërive të RIM, Ofruesin e Shërbimit Airtime ose ndonjë prej klientëve të tyre përkatës, ose infrastrukturën ose produktet ose shërbimet, dhe Ju do të pushoni menjëherë çdo aktivitet të tillë me dërgimin nga ana e RIM të të njëjtit njoftim për Ju;
- (e) Ju dhe Përdoruesit Tuaj të Autorizuar nuk do ta përdorni BlackBerry Solution Tuaj ose ndonjë pjesë të tij për të transmetuar, publikuar, postuar, ngarkuar, apo shpërndarë ndonjë Përmbajtje, të papërshtatshme, kërcënuese, abuzive, shpifëse, të pahijshme, të paligjshme dhe mashtruese.
- (f) Ju dhe Përdoruesit Tuaj të Autorizuar nuk do të përdorni BlackBerry Solution Tuaj apo ndonjë pjesë të tij, për të kryer apo tentuar për të kryer një krim ose për të lehtësuar dikë tjetër në kryerjen e një krimi ose akte të tjera ilegale apo të gabuara, duke përfshirë ngarkimin, grumbullimin, ruajtjen, postimin, transmetimin, komunikimin ose e thënë ndryshe mundësimin e çdo informacioni ose materiali të cilin Ju nuk keni të drejtë ta mbledhni, ruani ose ta mundësoni, duke përfshirë sipas çdo ligji ose kontrate ose në shkelje me çdo detyrë, në çanim të të drejtës private ose ligjit, lojërave ilegale të fatit, ose ndonjë veprë tjetër që mund të çenojë, dhunojë ose keqpërdorë ndonjë të drejtë të pronësisë intelektuale dhe/ose të drejta të tjera pronësie të ndonjë pale të tretë (duke përfshirë pa kufizim, kopjimin dhe ndarjen e Përmbajtjes për të cilën Ju dhe Përdoruesit Tuaj të Autorizuar nuk keni të drejta t'i kopjoni ose t'i ndani, ose të shmangni në mënyrë të paligjshme mbrojtjen e ndonjë të drejte dixhitale të menaxhimit);
- (g) Ju dhe Përdoruesit Tuaj të Autorizuar nuk do ta përdorni BlackBerry Solution, ose ndonjë pjesë të tij, për të ngarkuar, postuar, dërguar e-mail, transmetuar, ose e thënë ndryshe për të lejuar ndonjë program ose Përmbajtje që përmban ndonjë (i) virus, Trojan horse, worm, backdoor, mekanizem fikje, kod keqdashës, sniffer, bot, drop dead mechanism, ose spyware; ose (ii) ndonjë program tjetër ose Përmbajtje që synon të (A) ketë një impakt të pafavorshëm në performancën e, (B) të çakordojë, korruptojë ose të shkaktojë dëmtimin e, ose (C) të shkaktojë ose lehtësojë akses të pa-autorizuar ose të heqë aksesin e autorizuar nga, ose të shkaktojë përdorimin për qëllime të pa-autorizuara dhe të pa-përshtatshme, të çdo programi, hardware, shërbimi, sistemi, ose të dhënash ("Malëare") (dhe nëse Ju bëheni i ndërgjegjshëm për ekzistencën e çdo Malëare në lidhje me BlackBerry Solution, Ju duhet të njoftoni menjëherë RIM);
- (h) Ju dhe Përdoruesit Tuaj të Autorizuar nuk do të shisni, lëni me qira, lizing, transferoni, apo tentoni të shisni, lëni me qira, lizing ose transferoni, Programin apo ndonjë pjesë të Përmbajtjes, e cila ju është mundësuar si pjesë e Shërbimit RIM, ose të drejtën Tuaj për të përdorur Shërbimet RIM ose ndonjë pjesë të tyre ( duke përfshirë byronë e shërbimit

operativ ose shërbimin ekuivalent që përdor Programin) tek ndonjë person tjetër, ose në rastin e Programit të para-instaluar, për përdorimin e ndonjë pajisjeje tjetër, pa miratimin paraprak me shkrim të RIM;

- (i) Ju dhe Përdoruesit Tuaj të Autorizuar nuk do të tentoni të merrni akses të pa-autorizuar nga Shërbimet e RIM, llogari të tjera, sisteme kompjuterike ose shërbime që lidhen me një Shërbim të RIM, përmes piraterisë informatike, thyerjes së pasëordit ose ndonjë mjet tjetër, ose të merrni ose të tentoni të merrni ndonjë material ose informacion që është vënë në dispozicion përmes Shërbimit RIM, me anë të ndonjë mjeti i cili jo qëllimisht iu është mundësuar nga një Shërbim i tillë i RIM;
- (j) Ju dhe Përdoruesit Tuaj të Autorizuar nuk do të Përdorni BlackBerry Solution, ose ndonjë pjesë të tij për të impresionuar ndonjë person apo ent, ose për të deklaruar në mënyrë false ose e thënë ndryshe për të keqprezantuar filialin tuaj apo atë të Përdoruesit Tuaj të Autorizuar me një person ose ent, ose për të krijuar një identitet të pavërtetë për të mashtruar të tjerët, duke përfshirë mashtrimin me ane të postës elektronike;
- (k) Ju dhe Përdoruesit Tuaj të Autorizuar do të bashkëpunoni me RIM dhe do të siguroni informacionin e kërkuar nga RIM për të ndihmuar RIM në hetimin dhe përcaktimin nëse ka patur një shkelje të kësaj Marrëveshjeje dhe t'i mundësoni RIM ose një audituesi të pavarur të emëruar nga RIM, akses në ambientet dhe kompjuterat ku Produktet e RIM, Shërbimet e RIM ose Programi, ndodhen ose janë përdorur dhe ndonjë të dhënë në lidhje me to. Në këtë mënyrë Ju autorizoni RIM të bashkëpunojë me: (i) autoritetet e zbatimit të ligjit mbi hetimin e shkeljeve të dyshuara kriminale; (ii) palët e treta në hetimin e shkeljeve të kësaj Marrëveshjeje; dhe (iii) administratorët e sistemit në ofrimin e shërbimit të Internetit, rrjeteve apo pajisjeve të kompjuterit në mënyrë që kjo Marrëveshje të zbatohet. Një bashkëpunim i tillë mund të çojë në zbulimin e emrit të përdoruesit, adresën IP, apo informacioneve të tjera personale Tuajat ose të Përdoruesve Tuaj të Autorizuar.

4. Artikujt e kërkuar të Palës së Tretë dhe Shërbimet e Palës së Tretë. Ju mbani përgjegjësi për të siguruar se Artikujt e Palës së Tretë dhe Shërbimet e Palës së Tretë (duke përfshirë, sistemet kompjuterike, lidhjen me Internet, rrjetet pa-kabëll, implementimet e kriptografisë desktop dhe Shërbimet Airtime) me të cilat Ju zgjidhni të operoni BlackBerry Solution Tuaj, përmbushin kërkesat minimale të RIM, duke përfshirë, shpejtësinë e përpunimit, memorien, programin e klientit dhe mundësinë e aksesit të dedikuar në Internet të nevojshëm për BlackBerry Solution siç përcaktohet në Dokumentacion, dhe që përdorimi Juaj dhe i Përdoruesit Tuaj të Autorizuar i këtyre Artikujve të Palës së Tretë dhe/ose Shërbimeve të Palës së Tretë me BlackBerry Solution Tuaj, nuk është në shkelje të asnjë prej licencave, afateve, kushteve, ligjeve, rregullave dhe/ose rregulloreve në rrespektim të përdorimit të Artikujve dhe Shërbimeve të Palës së Tretë. Tarifat e Shërbimit Airtime mund të ngarkohen në lidhje me përdorimin Tuaj të BlackBerry Solution dhe Ju pranoni se në lidhjen mes Jush dhe RIM, ju mbani përgjegjësi për të gjitha tarifat e Shërbimit Airtime të shkaktuara gjatë këtij përdorimi. Ofruesi juaj i Shërbimit Airtime mund të kufizojë ato Shërbime të RIM dhe Shërbime të Palës së Tretë që janë bërë të disponueshme për Ju. Nëse Ju do të dëshironit informacion se cili prej Ofruesve të Shërbimit Airtime mbështet BlackBerry Solution Tuaj në zonën Tuaj, jeni të lutur të kontaktoni RIM në [legalinfo@rim.com](mailto:legalinfo@rim.com). Ju mund të zgjeroni implementimet kriptografike në desktopin tuaj (të tilla si s/MIME Versioni 3.0 (ose pauses) ose implementimet e bazuara në standardet RFC 2440, të tilla si PGP) për BlackBerry Handheld Tuajin, duke përdorur Programin, por RIM nuk suporton implementimet kriptografike të desktopit, të cilat janë Artikuj të Palës së Tretë dhe pa kufizuar refuzimet në Paragrafin 22, ASNJË RIM DHE AS FILIALET E SAJ NUK MBAJNË ÇFARËDO PËRGJEGJËSIE PËR NDONJË CËSHTJE NË LIDHJE ME IMPLEMENTIMIN E KRIPTOGRAFISË TUAJ TË DESKTOPIT.

#### 5. Kushtet Shtesë

- (a) Mund t'ju kërkohet të pranoni kushtet dhe afatet shtesë :
- i. me RIM në lidhje me Përbërësit e Palës së Tretë (p.sh. përbërësit e burimit të hapur) dhe në mënyrë që të përdorni disa Shërbime të RIM ose Përmbajtje të RIM ose për të siguruar një azhormim ose përmirësim të një Produkti të RIM ose të Shërbimit të RIM;
  - ii. me një palë të tretë për të blerë ose përdorur një Artikull të Palës së Tretë ose Shërbim të Palës së Tretë, duke përfshirë blerjen e Ofertës së palës së tretë përmes Magazinës RIME ose përdorimit të faqes së internetit të një Pale të Tretë; dhe
  - iii. me një MoR për të bërë blerjen përmes një Magazine të RIME ose blerjes së një Produkti In-App duke përdorur Shërbimin e Pagesës BlackBerry; dhe
  - iv. me një Ofrues Shërbimi Airtime për Shërbimet Airtime
- (b) Ju mbani përgjegjësi për tu pajtuar me çdo marrëveshje që Ju lidhni me një palë të tretë dhe RIM nuk do të mbajë përgjegjësi në asnjë mënyrë, për ndonjë humbje ose dëmtrim të çfarëdo lloji të shkaktuar si rezultat i marrëveshjeve Tuaja me ndonjërin prej palëve të treta. Nëse Ju nuk jeni të sigurtë se RIM është burimi i ndonjë Përmbajtjeje, artikulli, produkti ose shërbimi, jeni të lutur të kontaktoni RIM në [legalinfo@rim.com](mailto:legalinfo@rim.com). Nëse Ju bëni marrëveshje me palë të treta nëpërmjet internetit ose në bashkëpunim me Shërbimet e Palës së Tretë, bëni kujdes të siguroheni se me kë po bëni marrëveshje, dhe se i njihni kushtet dhe afatet që lidhen me ato faqe Interneti dhe çdo Shërbim të Palës së Tretë ose Artikuj të Palës së Tretë që Ju mund të aksesoni ose të merrni, duke përfshirë, shpërndarjen dhe kushtet e pagesës, kushtet e përdorimit, kushtet e licencës për përdoruesin fundor, kushtet e privatësisë, mjetet e privatësisë, dhe karakteristikat e sigurisë, për të mbrojtur informacionin Tuaj privat dhe për të garantuar sigurinë Tuaj personale.
- (c) Në asnjë rast këto kushte dhe afate shtesë ndërmjet Jush dhe ndonjë pale të tretë nuk do të jenë detyruese për RIM ose të imponojnë ndonjë detyrim shtesë, ose detyrime në kundërshti me kushtet dhe afatet e kësaj Marrëveshjeje, për RIM dhe për lidhjen mes Jush dhe RIM, kushtet dhe afatet në lidhje me Artikujt e Palës së Tretë dhe Shërbimet e Palës së Tretë do të vazhdojnë të zbatohen për ato artikuj.
- (d) Për aq sa çdo Përbërës i ndonjë Pale të Tretë mbulohet nga kushte dhe afate shtesë që ju japin të drejta përdorimi, kopjimi, shpërndarjeje ose modifikimi të një pjese ose të të gjithë Përbërësve të kësaj Pale të Tretë, më gjerësisht se të drejtat që ju jepen nga kjo Marrëveshje për Programin, atëherë, vetëm për aq sa Ju mund të ushtroni këto të drejta më gjerësisht pa shkelur kushtet dhe afatet e kësaj Marrëveshjeje për tepicën ose pjesët e mbetura të Programit, Ju do të siguroni përfitime nga këto të drejta shtesë. Sa i përket Programit të Palës së Tretë ose Shërbimeve të Palës së Tretë (të cilat përfshijnë programin dhe Përmbajtjen) që iu mundësohen nga RIME, përveç Programit të Palës së Tretë dhe Shërbimeve të palës së Tretë të shpërndara përmes Magazinës së RIME (e cila adresohet në Seksionin 9), nëse Programi i Palës së Tretë ose Shërbimi i Palës së Tretë nuk shoqërohet nga një licensë e vecantë ose nga kushtet e shërbimit, përdorimi i tij do t'i nënshtrohet kushteve dhe afateve të kësaj Marrëveshjeje sikur të ishin Programi ose Shërbimet e RIM (siç zbatohet) që janë pjesë e BlackBerry Solution Tuaj; me kusht që ky Program i Palës së Tretë ose Programi i Palës së Tretë t'ju mundësohet nga RIM "SIÇ ËSHTË" dhe "SIÇ MUNDËSOHET", pa kushte të shprehura ose të nënkuptuara, miratime, garanci, deklarime si dhe mes Jush dhe RIM, kufizimet dhe përjashtimet e përgjegjësisë, refuzimet dhe dispozitat e rimbursimit të paraqitura në këtë Marrëveshjeje për Artikujt e Palës së Tretë dhe Shërbimet e Palës së Tretë dhe jo për Programin, do të gjejnë zbatim. Çdo Program i Palës së Tretë që dërgohet në një BlackBerry Handheld iu ofrohet si komoditet nga RIM dhe nëse ju dëshironi të siguroni Programin e Palës së Tretë në terma të tjerë, Ju duhet të blini Programin e Palës së Tretë direkt nga furnizuesit e saj me kusht që ky Program i Palës së Tretë ose Shërbimet e Palës së Tretë ju ofrohen nga RIM "SIÇ ËSHTË" dhe "SIÇ MUNDËSOHET".

## 6. Shërbimet e RIM

- (a) Ndryshimi ose Ndërprerja e Shërbimeve të RIM. Ju pranoni se RIM, pa asnjë përgjegjësi ndaj jush, mund të modifikojë, pezullojë, ndërpresë, heqë, të vendosë limite mbi, ose të çaktivizojë ndonjë Shërbim të RIM në çdo kohë, përkohësisht ose përgjithmonë, me ose pa njoftim; me kusht që nëse RIM ndërpret për një kohë të gjatë një Shërbim RIM (rast në të cilin licenca Juaj për të përdorur çdo Program BlackBerry Handheld, i dizenuar në mënyrë specifike për të aksesuar atë Shërbim të RIM, do të ndërpritet automatikisht), dhe nëse Ju keni paguar që të keni atë Shërbim të RIM për një periudhë të caktuar kohe dhe nuk jeni në shkelje të kësaj Marrëveshjeje, Ju keni të drejtën e rimbursimit të një pjese ose të të gjithë shumës që Ju i keni paguar RIM për Shërbimin RIM, siç përcaktohet në politikat e atëhershme të rimbursimit të RIMt për shërbimin RIM. Një rimbursim i tillë, nëse ka, do të jetë e drejta juaj ekskluzive dhe detyrim vetëm i RIM ndaj Jush në rast se RIM në mënyrë të përhershme ndërpret një Shërbim të RIM.
- (b) Mirëmbajtja. Pa u kufizuar me sa më sipër, RIM rezervon të drejtën për dhe Ju pranoni se RIM, në gjykimin e tij mund të pezullojë vazhdimisht aksesin ndaj Shërbimeve të RIM, ose e thënë ndryshe të nxjerrë nga përdorimi Shërbimet e RIM, me qëllim rregullimin e përgjuesve të programeve, instalimin e azhronimeve dhe për të bërë diagnostikime dhe mirëmbajtje të tjera të Shërbimeve të RIM.

## 7. Kontributet Tuaja dhe Përmbajtje të Tjera

- (a) Fidbeku. Ju mund t'i jepni Fidbek RIM mbi BlackBerry Solution Tuaj. Vetëm nëse RIM ka rënë dakord ndryshe me shkrim, Ju pranoni se RIM do të zotërojë të gjithë fidbekun, komentet, sugjerimet, idetë, konceptet dhe ndryshimet që Ju i ofroni RIM në lidhje me 'BlackBerry Solution Tuaj' dhe të gjitha të drejtat në lidhje me të mbi pronësinë intelektuale (bashkërisht "Fidbeku") dhe ju nëpërmjet kësaj i caktoni RIM të gjitha të drejtat Tuaja, tituj dhe interesa në të. Ju nuk do t'i ofroni RIM me vetëdije ndonjë Fidbek që është objekt i të drejtave mbi pronësinë intelektuale të ndonjë pale të tretë. Ju pranoni të bashkëpunoni plotësisht me RIM në lidhje me nënshkrimin e dokumenteve të tjera dhe për të bërë këto veprime të tjera siç kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga RIM për të konfirmuar se RIM zotëron Fidebekun dhe për të lejuar RIM të regjistrojë dhe/ose mbrojë ndonjë të drejtë mbi pronësinë intelektuale dhe/ose informacionin konfidencial.
- (b) Përmbajtja e Përdoruesit Fundor, Artikujt e Palës së Tretë. Ju dhe jo RIM, jeni plotësisht përgjegjës për Përmbajtjen Tuaj. RIM nuk kontrollon Përmbajtjen apo Artikujt të tjerë të Palës së Tretë që iu mundësohen nga përdoruesit fundor në lidhje me BlackBerry Solution të tyre ose ndonjë Shërbim të Palës së Tretë që përdoret në lidhje me BlackBerry Solution të tyre, dhe krahas refuzimeve të përgjithshme në Seksionin 22, RIM nuk garanton saktësinë, integritetin, ose cilësinë e dhe nuk mban përgjegjësi për ndonjë Artikull të tillë të Palës së Tretë. RIM mund të krijojë praktika të përgjithshme dhe kufizime në lidhje me përdorimin e Shërbimeve të RIM, duke përfshirë volumin e Përmbajtjes që mund të ruhet, periudhën maksimale kohore gjatë së cilës Përmbajtja ose postimet e mesazhit/diskutimit do të mbahen nga Shërbimi RIM (duke përfshirë ndonjë shërbim magazinimi) dhe/ose periudhën gjatë së cilës Ju mund të vazhdoni të përdorni ose të aksesoni Përmbajtjen. Ju mund të përdorni Përmbajtjen që ju mundësohet nga RIM ose një filial i RIM në lidhje me një Shërbim të RIM, vetëm për përdorimin Tuaj personal dhe në perputhje me kushtet dhe afatet përkatëse të licensimit të zbatueshme për Shërbimin e RIM. Ju nuk mund ta përdorni Përmbajtjen që iu jepet si pjesë e shërbimit "BBM Music" zilet e telefonit. Kufizimet të tilla si ato të paraqitura më sipër do të detajohen në Dokumentacionin për Shërbimin e zbatueshëm të RIM, me të cilin Ju duhet të familjarizoheni dhe ta rishikoni herë pas here pasi RIM mund të bëjë ndryshime të mundshme. Ju pranoni se RIM nuk ka përgjegjësi ose detyrime të cfaredo lloji për humbjen, fshirjen e, aksesit të paautorizuar, ose mos-ruajtjen e ndonjë Përmbajtjeje dhe nëse ju Ju keni të drejtat ose licensat e nevojshme për ta bërë këtë, Ju duhet të ruani një kopje alternative shtesë të një Përmbajtjeje për të cilën mbajtja e kopjes është e rëndësishme për Ju.

- (c) Përmbajtja Juaj. Ndryshe nga sa paraqitet shprehimisht në këtë Marrëveshje ose në ndonjë shtojcë të saj, kjo Marrëveshje nuk transferon ndonjë pronësi të Përmbajtjes Tuaj tek RIM. Në lidhje me çdo Përmbajtje të tillë që Ju ose Përdoruesit Tuaj të Autorizuar mundësoni për përfshirjen në faqe interneti të aksesueshme nga publiku ose në aspekte të tjera të aksesueshme publikisht të Shërbimeve të RIM, Ju i jepni RIM një licensë botërore, të vazhdueshme, të revokueshme, të transferueshme, të zhveshura nga renta dhe jo-ekskluzive për të përdorur, shpërndarë, riprodhuar, modifikuar, përshtatur, kryer publikisht dhe shfaqur publikisht atë Përmbajtje siç kërkohet në mënyrë të arsyeshme në lidhje me ofrimin dhe menaxhimin e ndonjë Shërbimi të RIM dhe në lidhje me ndonjë Përmbajtje që Ju ose Përdoruesit Tuaj të Autorizuar bëjnë të mundur për qëllime të tjera të Shërbimeve të RIM, ju i jepni RIM një licensë botërore, të vazhdueshme, të revokueshme, të transferueshme, të zhveshura nga renta dhe jo-ekskluzive për të përdorur, shpërndarë, riprodhuar, modifikuar, përshtatur, kryer publikisht dhe shfaqur publikisht këtë Përmbajtje siç kërkohet në mënyrë të arsyeshme për t'ju ofruar Ju Shërbimin RIM; dhe ju deklaroni dhe pranoni në të dyja rastet se Ju keni të drejtë t'i jepni RIM një licensë të tillë.
- (d) Përmbajtje e Kundërshtueshme dhe Artikujt e Palës së Tretë. Ju pranoni se duke përdorur BlackBerry Solution Tuaj ose një Shërbim të Palës së Tretë, Ju dhe Përdoruesit Tuaj të Autorizuar mund të ekspozoheni ndaj Përmbajtjes dhe Artikujve të Palës së Tretë që janë, ose që Ju ose Përdoruesit Tuaj të Autorizuar i vlerësoni si, fyese, të pahijshme, ose e thënë ndryshe të kundërshtueshme. RIM dhe të emëruarit e tij do të kenë të drejtë (por jo përgjegjësi) në gjykimin e tyre të vetëm të parashikojnë, refuzojnë ose të heqin ndonjë Artikull të Palës së Tretë nga Shërbimi RIM.
- (e) Kontrollat Prindërore dhe Mbikëqyrja e të Rriturve. Pjesë të BlackBerry Solution Tuaj ose Shërbimet e Palës së Tretë mund të përfshijnë rregullime që Ju lejojnë të bllokoni ose të filtronin Përmbajtje të caktuara, Shërbime RIM, ose Shërbime të Palës së Tretë ose të Palëve të Treta. Është plotësisht përgjegjësi e Juaj t'i zgjidhni dhe t'i lejoni këto rregullime në preferencat Tuaja. RIM nuk garanton se këto rregullime janë të pa-gabueshme, do të bllokojnë të gjithë Përmbajtjen në lidhje me të, Shërbimet RIM, Shërbimet e Palës së Tretë ose të Palëve të Treta, ose se nuk mund të çaktivizohen ose shmangen nga të tjerë që kanë akses në BlackBerry Solution Tuaj. Nëse Ju lejoni fëmijën tëuaj të dëgjojë, ose të shikojë ose të aksesojë Programin, Shërbimet RIM, Shërbimet e Palës së Tretë ose Artikuj të Palës së Tretë në Produktin tuaj Handheld, është në përgjegjësinë tuaj të vendosni nëse ky Program, Shërbimet RIM, Shërbimet e Palës së Tretë ose Artikujt e Palës së Tretë janë të përshtatshme për fëmijën Tuaj, dhe ju mbani përgjegjësi të plotë për aksesin dhe përdorimin e Programit, të Shërbimeve RIM, të Shërbimeve të Palës së Tretë dhe të Artikujve të Palës së tretë nga fëmija Juaj, duke përfshirë të gjitha komisionet financiare ose detyrime të tjera që shkaktohen në lidhje me këtë përdorim ose akses.
- (f) Heqja e Programit dhe Artikujt e Palës së Tretë. Ju pranoni se herë pas here RIM mund të heqë Programin ose Artikujt e Palës së Tretë nga Shërbimi RIM duke përfshirë Magazinën RIME ose "BOTA IME" dhe kur kërkohet ligjërisht ose ku Programi ose një Artikull i Palës së Tretë interferon me, zvogëlon performancën, ose ka efekt negativ në ndonjë program, hardware, sistem, rrjet ose të dhëna, duke përfshirë ndonjë pjesë të BlackBerry Solution Tuaj dhe/ose të përdoruesve të tjerë, mund të heqë këtë Program ose Artikull të Palës së Tretë nga Produkti Juaj Handheld, të pezullojë aksesin ndaj Shërbimit të zbatueshëm RIM ose Shërbimit të Palës së Tretë për periudha të pacaktuara kohore, ose të ndalojë së ofruari këto për Ju në çdo kohë, pa njoftim paraprak dhe sipas Seksionit 6(a), Ju nuk do të bëni rekurs kundër RIM në rast se kjo do të ndodhë.
- (g) Të Drejta Shtesë Revokimi. Për aq sa ndalohet me ligj, RIM ka të drejtën, në gjykimin e tij të vetë dhe në çdo kohë, për çfarëdo arsye dhe pa iu njoftuar, të ndryshojë, pezullojë, heqë, çaktivizojë, kufizojë, pengojë ose të përfundojë aksesin Tuaj dhe të heqë nga Produkti Juaj BlackBerry

Handheld ndonjë Program ose Artikull të Palës së Tretë, duke përfshirë, çaktivizimin ose heqjen e funksionimit të këtyre materialeve që janë instaluar tashmë në një Produkt HandHeld dhe Ju nuk do të bëni rekurs kundër RIM në rast se kjo do të ndodhë.

#### 8. Informacione për Sigurinë në lidhje me Përdorimin e Teknologjisë

- (a) Simptomat fizike. Në raste të rralla njerëzit përjetojnë kriza dhe verbim për shkak të ekspozimit ndaj ndezjes së dritës dhe modeleve që gjenden shpesh në teknologji, të tilla si video-games. Nëse ju e keni bërë këtë, ose keni patur ndjesinë e të përzierit, lëvizje të pavullnetshme, ndjesinë e mpirjes apo të shpimit gjatë përdorimit të teknologjisë në të shkuarën, Ju duhet të konsultoheni me mjekun Tuaj para përdorimit të një teknologjie të ngjashme dhe duhet të ndaloni menjëherë përdorimin e kësaj teknologjie në rast se simptomat iu shfaqen sërish. Në çdo rast Ju duhet të shmangni përdorimin e zgjatur të teknologjisë dhe të minimizoni ndonjë siklet të mundshëm ose lodhjen, duke përfshirë ndonjë tendosje të muskullit të syve dhe duhet të monitoroni me kujdes përdorimin e teknologjisë nga fëmijët Tuaj dhe të shmangni problemet e mundshme.
- (b) Shërbimet e Emergjences. Karakteristikat e video-call të Programit BlackBerry Handheld nuk janë të ndërlidhura me një rrjet telefonik publik (PSTN), nuk përdorin numrat e telefonit për tu lidhur me pajisje të tjera dhe nuk janë të destinuara ose të synuara për të qenë zëvendësues të celularit Tuaj të zakonshëm ose të linjës së telefonisë fikse. Për më tepër, Ju pranoni dhe bini dakord se as Programi BlackBerry Mobile Voice (“MVS”) as karakteristikat e video-chat-it të Programit nuk janë të dizenuara ose të synuara për tu kthyer në zëvendësues të linjës Tuaj tradicionale fikse ose të telefonit celular pa-kavëll dhe se ato nuk mund të përdoren për të kryer telefonata drejt numrave “911”, “112”, “999”, “000” ose numra të tjerë të destinuar për të lidhur një përdorues me pikat publike që përgjigjen për sigurinë ose shërbime emergjence të ngjashme sipas ligjeve vendore të telekomunikacionit (“Shërbimet e Emergjencës”). Telefonatat drejt Shërbimeve të Emergjencës nuk procesohen përmes karakteristikave të video-chat-it ose të MVS-së dhe do të procesohen vetëm nga Produkti BlackBerry Handheld aty ku ka mbulim të telefonisë pa-kabëll nga një Ofrues i Shërbimit Airtime. Ju kuptoni dhe pranoni se marrëveshjet shtesë, të ndara nga MVS ose funksionaliteti i video-chat-it të Programit, duhet të bëhet për të aksesuar Shërbimet e Emergjencës dhe se Grupi i Shoqërive RIM dhe i nëpunësve të saj përkatës, i drejtorëve dhe punonjësve nuk do të mbajnë përgjegjësi ose detyrim të çfarëdo lloji për ndonjë lëndim personal, vdekje ose dëmtime që dalin nga ose në lidhje me pa-aftësinë për të aksesuar Shërbimet e Emergjencës përmes MVS ose funksionalitetit të video-chat-it të Programit.

#### 9. Magazina(t) RIME. Kushtet dhe afatet e mëposhtme gjejnë zbatim për Ju dhe për Përdoruesit Tuaj të Autorizuar për përdorimin e Magazinës(ave) RIME:

- (a) Zbatueshmëria e Kushteve ndaj Ofertave. Vetëm nëse parashikohet ndryshe në Seksionin 9, të gjitha kushtet dhe afatet në këtë Marrëveshje në lidhje me Programin, Produktet e RIM, Artikujt e Palës së Tretë, Shërbimet e RIM dhe Shërbimet e palës së Tretë janë të zbatueshme për llojin e Ofertave korresponduese. RIME kryen të gjitha transaksionet e tregtisë elektronike të Grupit të Shoqërive RIM për juridiksionin Tuaj, dhe në përputhje me të, në kontekstin e shpërndarjes së Ofertave të Magazinës RIME dhe blerjeve për Produkte In-App, të gjitha referencat në këtë Marrëveshje për RIM do të konsiderohen se i referohen RIME.
- (b) Ndryshimet. RIME ka të drejtën, në gjykimin e tij të vetëm të bëjë azhornime, modifikime dhe përshtatje të një magazine RIME pa njoftim paraprak. Duke përfshirë ndryshimin e Ofertave të disponueshme, përshkrimin e Ofertave dhe afatet, me kusht që këto ndryshime të gjejnë zbatim në baza të ardhshme.

- (c) Vendndodhja e Ofertave. Pavarësisht se një Ofertë shfaqet në Magazinën RIME ajo mund të mos jetë e disponueshme përmes magazinës RIME në të gjitha juridiksionet. RIME ka të drejtë që në gjykimin e tij të përjashtojë ose e thënë ndryshe të kufizojë mundësimin e Ofertës ndonjë personi ose enti me banim në ndonjë juridiksion ose zonë gjeografike dhe të mos përdorë teknologjitë dhe informacionin në lidhje me operatrin tuaj dhe/ose pajisjen, për të identifikuar juridiksionin Tuaj ose zonën gjeografike për të lehtësuar këto përjashtime ose kufizime. Pa kufizuar sa më sipër, Ofertat mund të shkarkohen, instalohen dhe/ose përdoren vetëm në juridiksionet e autorizuara nga Kushtet e zbatueshme të Shitësit (të përshkruara më poshtë) ose siç mund të përcaktohen ndryshe nga Shitësi. Produktet In-App janë të disponueshme vetëm në juridiksionet ku Oferta e magazinës RIME përmes së cilës Produkti In-App mundësohet, është gjithashtu e disponueshme për ju.
- (d) Të miturit. Ofertat synohen për individët me kapacitetin dhe aftësinë e nevojshme për të pranuar ligjërisht ofrimin e informacionit të kërkuar dhe për të nënshkruar një kontratë. Ju pranoni të mbikëqyrni dhe të mbani përgjegjësi për të çdo përdorim nga të miturit të një depozite të RIME dhe të blerjeve të Produkteve In-App në emrin dhe llogarinë Tuaj.
- (e) Ofruesit e Shërbimit. RIME mund të përdorin një sërë ofrues shërbimesh, duke përfshirë anëtarë të tjerë të Grupit të Shoqërive të RIM për të pritur, operuar dhe ofruar përmbushjen dhe shërbime të tjera për magazinën e RIME dhe Shërbimin e Pagesave të BlackBerry (“Ofruesit e Shërbimeve”).
- (f) MoRs e Palës së Tretë. RIME mundëson për ju dhe Përdoruesit Tuaj të Autorizuar Magazinën RIME, por mund të mos jetë Tregtari i Regjistrimeve për të gjitha Magazinën e RIME ose Kioskat ose për të gjitha blerjet e Produkteve In-App. MoRs e Palës së Tretë do të identifikohen në momentin e blerjes në një Magazinë RIME ose të një Produkti In-App, ato ju mundësojnë Shërbime të Palës së Tretë dhe krahas kushteve dhe afateve shtesë, mund t’ju kërkojë të zotëroni një llogari me procesor specifik pagese, të tillë si PayPal, Inc., në mënyrë që të kryeni blerjen.
- (g) Kushtet e Shitësit. E drejta juaj për të përdorur ndonjë Ofertë që iu është shpërndarë përmes magazinës RIME, duke përfshirë të drejtën Tuaj për të aksesuar dhe përdorur ndonjë Ofertë që është shërbim, i nënshtrohet kushteve dhe afateve të çdo marrëveshjeje përdoruesi fundor që përfshihet në Ofertën (“Kushtet e Shitësit”). Nëse një Shitës Oferte nuk arrin të ofrojë Kushtet e Shitësit në lidhje me një Ofertë, atëherë Ju pranoni se përdorimi Juaj i kësaj Oferte do të jetë objekt i kushteve dhe afateve të një marrëveshjeje me të njëjtat kushte dhe afate me këtë Marrëveshje, sikur Oferta të ishte Program ose Shërbim i RIM (sipas rastit) që bën pjesë në BlackBerry Solution Tuaj, me modifikimet e mëposhtme; i) Shitësi i Ofertës do të konsiderohet të jetë licensuesi ose ofruesi i shërbimit, sipas rastit, ii) Oferta iu është paraqitur Juve nga RIME ose filialet e saj “Siç Është” dhe “Siç Mundësohet”, pa kushte të shprehura apo të nënkuptuara, miratime, garanci, deklarime; dhe iii) si ndërmjet Jush dhe RIME, kufizimet dhe përjashtimet e përgjegjësisë dhe dispozitat e rimbursimit të paraqitura në këtë Marrëveshje për llojin e zbatueshëm të Ofertës së Palës së Tretë dhe jo për Programin apo Shërbimet e RIM, do të gjejnë zbatim.
- (h) Ofertat për Përdorim Personal të BlackBerry Handhelds dhe jo Për Rishitje. Pavarësisht ndonjë kushti ose afati në kushtet dhe afatet për një Ofertë të vecantë, Ju pranoni dhe deklaroni se Ju do të bleni Oferta vetëm për përdorimin Tuaj personal dhe jo për t’i shitur ose ri-shitur dhe se Ju do të shkarkoni, instaloni dhe/ose përdorni Ofertat që janë aplikacione programi për platformën e programit të RIM që operon në një Produkt HandHeld.
- (i) Mbështetja e kufizuar. Në lidhje me Magazinën e RIME, the Artikujt e Palës së Tretë dhe Shërbimet e Palës së Tretë të cilat janë vënë në dispozicion me anë të Magazinës RIME, RIME do të mbajë përgjegjësi për: (a) shërbime me mbështetje të kufizuar në lidhje me Programin dhe vetëm çështjet e shkarkimit të Artikujve të Palës së Tretë; dhe (b) shërbimet mbështetëse të linjës së parë



për problemet teknike që Ju mund të hasni në lidhje me Programin BlackBerry HandHeld i cili lehtëson aksesin ndaj, dhe përdorimin e Magazinës RIME. Jeni të lutur t'i referoheni faqes së internetit për ndihme për Magazinën e zbatueshme të RIME për shërbime mbështetëse që janë aktualisht të disponueshme.

- (j) Përmirësimet e Paguara. Në disa raste RIM mund të krijojë një version bazë ose të kufizuar në kohë të një Shërbimi të RIM ose të një artikulli të Programit që iu mundësohet Ju ose në pajisje siç dërgohet ose përmes Magazinës RIME, por kërkon që Ju të bleni një version të përmirësuar të Shërbimit RIM (ose një abonim të përmirësuar ndaj Shërbimit RIM) ose ng aky Program në mënyrë që të siguroni funksionalitet shtesë ose të përdorni Shërbimin RIM ose Programin pas një periudhe fillestare prove.
- (k) Përgjegjësitë e MoR dhe RIME për Artikujt e Palës së Tretë dhe Shërbimet e Palës së Tretë. As MoRs e Palës së Tretë as RIME nuk kanë ekspertizë teknike në lidhje me Artikujt e Palës së Tretë ose Shërbimet e Palës së Tretë që vihen në dispozicion përmes Magazinës RIME. Shitësit e Ofertave mbajnë përgjegjësi për deklaratimet dhe mbështetjen e Ofertave të tyre. Ju do të keni përfitimin e garancisë së Shitësit të Ofertës (nëse ka) me Ofertat e tyre. Garancitë do të variojnë ndërmjet Shitësve të Ofertës si edhe ndërmjet juridiksioneve për një Shitës të vecantë Oferte. Ju duhet t'i referoheni dokumentacionit përkatës ose Kushteve të Shitësit të ofruara me Ofertën për të zbuluar se çfarë mbështetje po ofron një Shitës Oferte për një Ofertë të vecantë dhe të drejtat Tuaja në lidhje me mbështetjen dhe garancitë. Vetëm nëse është rënë dakord ndryshe ose kërkohet nga ligji i zbatueshëm, çdo garanci e dhënë në lidhje me Ofertat zgjatet vetëm për Ju me mirëkuptimin se Ju jeni një përdorues dhe jo një ri-shitës i këtyre Ofertave. Përveç rasteve të kërkuara shprehimisht me ligj, ose nga një politikë kthimi e MoR (nëse ka) për Artikullin specifik të Palës së Tretë ose Shërbimin e Palës së Tretë, as MoRs, as RIME qoftë duke vepruar për llogari të vetë ose si Ofrues Shërbimi për MoR, nuk do të mbajnë përgjegjësi për t'ju ofruar ndonjë mbështetje operacionale ose teknike ose për rimbursimin e Artikujve të Palës së Tretë ose Shërbimet e Palës së Tretë që mundësohen përmes Magazinës RIME.
- (l) Rimbursimi ose të Drejtat e Garancisë. Nëse pavarësisht dispozitave të kësaj Marrëveshjeje RIME i kërkohet sipas ligjeve të zbatueshme në juridiksionin Tuaj të ofrojë rimbursim shtesë ose të drejta garancie për një Ofertë, RIME do të mundësojë këto kompensime sipas kërkesave të ligjit dhe, aty ku lejohet, RIM mund të zgjedhë të ofrojë një ose më shumë Produkte Alternative RIM, Programe, Shërbime të RIM, Artikuj të Palës së Tretë ose Shërbime të Palës së Tretë.
- (m) Produktet In-App dhe Shërbimi i Pagesave BlackBerry. Shërbimi i Pagesave BlackBerry lejon Shitësit e Ofertës të bëjnë të disponueshme për Ju produktet dhe shërbimet dixhitale brenda Programit të Palës së Tretë ose Programit. Ju pranoni se Produktet e Palës së Tretë In-App nuk janë ruajtur në serverat e RIME, nuk shpërndahen përmes Magazinës RIME dhe Ju pranoni se është Shitësi i Ofertës së këtyre Produkteve In-App, dhe jo RIME, ai që mban përgjegjësi për përmbushjen e porosive Tuaja për Produktet In-App dhe për t'ju shpërndarë Produktet In-App.

10. Bota Ime. Pasi të keni shkarkuar ndonjë Program ose Artikull të Palës së Tretë përmes një Shërbimi RIM ose Shërbimi të Palës së Tretë, është në përgjegjësinë Tuaj dhe as RIME apo filiale të saj nuk do t'ju detyrohen për ndonjë humbje, shkatërrim ose dëmtim të ndonjë prej këtyre materialeve. Magazina Bota Ime Ju lejon të çinstaloni dhe të ri-instaloni Programe të caktuara dhe Artikuj të Palës së Tretë në Produktin tuaj HandHeld siç detajohet më tej në rregullat në fuqi në atë kohë për Bota Ime. Ju pranoni dhe bini dkaord se rregullat dhe karakteristikat e Bota Ime mund të ndryshojnë kohë-pas-kohë dhe pranoni t'i përmbaheni rregullave që zbatoheshin në atë kohë.

11. Pronësia Intelektuale. Ju ose Përdoruesit Tuaj të Autorizuar nuk do të kërkonin nëpërmjet kësaj ndonjë të drejtë pronësie, titull ose interes në ndonjë pronësi intelektuale ose të drejta të tjera pronësie, duke përfshirë patentat, dizajnet, markat tregtare, të drejtën e autorit, të drejtat e bazës së të dhënave ose të drejta mbi ndonjë informacion konfidencial ose sekrete tregtare, për ose në lidhje me BlackBerry Solution Tuaj ose të ndonjë pjese të saj, duke përfshirë Përmbajtjen që iu është vënë në dispozicion nga RIM ose filialet e saj dhe ofruesit e saj përkatës si pjesë e Shërbimit të RIM, sipas kësaj Marrëveshjeje. Ju gjithashtu nuk do të merrni ndonjë të drejtë licensimi për ose në lidhje me BlackBerry Solution Tuaj ose të ndonjë pjese të tij, ose për ndonjë Përmbajtje që Ju është mundësuar përmes një Shërbimi RIM, i ndryshëm nga të drejtat që ju lejohen Ju shprehimisht sipas kësaj Marrëveshjeje, në Dokumentin përkatës, ose në një dokument tjetër të pranuar reciprocikisht me marrëveshje me shkrim që Ju mund të keni lidhur me RIM. Asnjë titull dhe/ose ndonjë e drejtë posedimi për Produktin (et) RIM (nëse ka) nuk jepet me anë të kësaj Marrëveshjeje dhe asnjë titull për ndonjë Beta Hardware nuk kalon tek ju tërësisht. Të gjitha të drejtat që nuk jepen shprehimisht këtu rezervohen shprehimisht. Për qartësim, pavarësisht gjithçka tjetër në këtë Marrëveshje, në asnjë rast licensat e patentave të dhëna në këtë Program nuk do të zgjaten, ose të interpretohen/construe për tu zgjatur, për përdorimin e ndonjë prej Shërbimeve të Palës së Tretë ose Artikujve të Palës së Tretë qoftë veçmas ose në ndërthurje me BlackBerry Solution Tuaj dhe pa u kufizuar me sa më sipër, në asnjë rast licensat e dhëna këtu nuk do të interpretohen në mënyrë të tillë që çdo Ofrues i këtyre Shërbimeve të Palës së Tretë ose të Artikujve të Palës së Tretë, të jetë i aftë të vlerësojë me sukses se përdorimi i këtyre Shërbimeve të Palës së Tretë ose të Artikujve të Palës së Tretë, qoftë në bashkëpunim me një pjesë ose me gjithë BlackBerry Solution ose vetëm, janë të licensuara sipas patentave të RIM me anë të faktit se Programi është licensuar më poshtë. Programi dhe kopjet që Ju i bëni Programit, vetëm ju jepet dhe nuk shitet dhe Programi, gjithë Dokumentacioni dhe Përmbajtja që ju jepet nga RIM ose nga filialet e saj si pjesë e Shërbimit RIM dhe ndonjë faqe(t) që ju lejon të përdorni ndonjë prej Shërbimeve të RIM, mbrohen nga ligjet Kanadeze, Amerikane dhe ndërkombëtare për të drejtën e autorit dhe patentat dhe dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare. Këto janë penalitete të ashpra, si civile dhe kriminale për shkeljen e pronës intelektuale. Ju pranoni se asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të ndikojë negativisht në të drejtat dhe rekurs ndaj çdo kompensimi, duke përfshirë injunctive relief që RIM dhe ndonjë ofrues tjetër i Përmbajtjes për një Shërbim të RIM mund të kenë sipas ligjeve të zbatueshme në lidhje me mbrojtjen e Përmbajtjes së RIM ose të ofruesve të pronësisë intelektuale ose të të drejtave të tjera të pronësisë.

12. Eksporti, Importi dhe Kufizimet e Përdorimit dhe Licensat e Qeverisë Amerikane. Ju pranoni se Produktet RIM dhe Programi mund të përfshijë teknologjinë kriptografike dhe nuk do të eksportohen, importohen, të përdoren, transferohen apo të ri-eksportohen përveç se kur lejohet nga ligji dhe rregulloret e autoriteteve përkatëse qeveritare. Nëpërmjet kësaj ju deklaroni se: (A) për aq sa Ju keni njohuri Ju pranoheni të merrni Produktin(et) RIM dhe Programin sipas ligjit të zbatueshëm; (B) Ju nuk do të përdorni Produktet RIM dhe Programin për zhvillimin, prodhimin, mirëmbajtjen, ruajtjen, zbulimin, identifikimin ose shpërndarjen e armëve kimike, biologjike, nukleare ose sistemeve të tyre reaktive, ose të materialeve ose pajisjeve që mund të përdoren në këto armë ose në sistemet e tyre të shpërndarjes reaktive, ose të ri-shisni, eksportoni drejt donjë personi ose enti të përfshirë në këtë veprimtari; dhe (C) Ju do të siguronit që Përdoruesit e Autorizuar të përdorin Produktin(et) RIM dhe Programin në përputhje me kufizimet e mësipërme. Pavarësisht ndonjë marrëveshjeje me një palë të tretë ose ndonjë dispozitë ligjore, rregulloreje ose politike, nëse Ju jeni një agjensi e qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, atëherë të drejtat Tuaja në lidhje me Programin nuk do t'i tejkalojnë të drejtat e parashikuara në këtë Marrëveshje, përveç nëse shprehimisht është rënë dakort me RIM në një marrëveshje me shkrim ndërmjet Jush dhe RIM, e cila është firmosur nga një Drejtori i Operacioneve ose Drejtori Ekzekutiv i RIM.

13. Siguria, Llogaritë dhe Fjalëkalimet. Ju pranoni të merrni përgjegjësi të plotë për vendosjen e masave të duhura të sigurisë për të kontrolluar aksesin në Produktin Tuaj HandHeld dhe në sistemin kompjuterik me të cilin ai vepron. Pa u kufizuar me sa më sipër, Ju pranoni të zgjidhni fjalëkalime të forta dhe të mbronin sigurinë dhe konfidencialitetin për të gjitha fjalëkalimet e përdorura për të aksesuar BlackBerry Solution

Tuaj ose të ndonjë pjese të tij, duke përfshirë fjalëkalimet e përdorura për të aksesuar ndonjë llogari të krijuar në lidhje me BlackBerry Solution Tuaj. Më tej Ju pranoni se mbani përgjegjësi për të gjithë aktivitetin që ndodh gjatë përdorimit të fjalëkalimeve Tuaja, në ose përmes llogarive Tuaja, duke përfshirë të gjitha komisionet financiare ose detyrime të tjera të kryera në lidhje me këtë veprimtari. Ju pranoni të njoftoni menjëherë RIM për çdo përdorim të paautorizuar të një pjese të ose të gjithë BlackBerry Solution Tuaj, duke përfshirë ndonjë fjalëkalim për ndonjë pjesë të BlackBerry Solution Tuaj, duke kontaktuar Mbështetjen për Klientin e RIM (informacione kontakti që gjenden në [www.BlackBerry.com/support](http://www.BlackBerry.com/support)). RIM mund të marrë masa të tilla që ai i çmon të përshtatshme sipas faturës së këtij lajmërimi, por nuk ka detyrim për të marrë ndonjë masë. RIM mund të marrë masa të tilla që ajo i vlerëson të përshtatshme pas marrjes së këtij njoftimi, por nuk mban përgjegjësi për marrjen e masave të tjera. Ju pranoni se duke njoftuar RIM sipas sa më lart nuk do t'ju shkarkojë Ju nga përgjegjësia për të gjitha veprimtaritë që ndodhin me përdorimin e fjalëkalimeve Tuaja ose përmes llogarive Tuaja.

#### 14. Ndryshimi ose Humbja/Vjedhja e Pajisjeve; Back-up/Fshirja e të dhënave

- (a) Pajisjet e Humbura/të Vjedhura. Nëse mendoni se Produkti Juaj HandHeld është vjedhur, Ju duhet të kontaktoni me (një) zbatues të ligjit vendor. Nëse Produkti Juaj HandHeld ka humbur, ose Ju mendoni se është vjedhur dhe Ju keni regjistruar Produktin Tuaj HandHeld me një Shërbim RIM, të tillë si BlackBerry Protect që mundëson vendodhjen e pajisjes, kyçjen ose heqjen e karakteristikave të fshirjes së të dhënave, Ju duhet të përdorni këtë Shërbim të RIM për të synuar lokalizimin ose për të fshirë veçmas ose kyçur Produktin Tuaj HandHeld. Pavarësisht sa më sipër dhe pa u kufizuar me refuzimet e përgjithshme në Seksionin 22, RIM dhe shoqëritë e saj të kontrolluara nuk mund të sigurojnë: (i) disponibilitetin, saktësinë, plotësinë, besueshmërinë ose lehtësinë e vendodhjes së të dhënave ose të ndonjë të dhëne tjetër të aksesuar përmes shërbimeve të vendodhjes, ose (ii) se fshirja në distancë, kyçja në distancë ose funksionalitet tjetër i këtyre shërbimeve do të kryhet me sukses, pasi mbulimi i Shërbimit Airtime për Ofruesin e Shërbimit Tuaj Airtime, kushti i Produktit Tuaj HandHeld dhe burimet e sistemit nuk mund të njihen në momentin e kërkesës.
- (b) Mbështetja/Fshirja e të Dhënave. RIM rekomandon, me kusht që ju të të keni të drejtat ose licensat e nevojshme për ta bërë këtë, në mënyrë që Ju të bëni “back-up” të të gjithë e-mailave, Përmbajtjes dhe Programi i Palës së tretë që Ju kërkoni dhe/ose të dhënat në Produktin Tuaj HandHeld, si në shumë raste këto të dhëna nuk ruhen ose e thënë ndryshe nuk mbështeten nga ose në emër të RIM. Nëse ju transferoni Produktin Tuaj HandHeld (siç lejohet nga BBSLA) për çfarëdo arsye, duke përfshirë në lidhje me shërbimin e Produktit Tuaj HandHeld, vetëm nëse Ju fshini të gjitha të dhënat nga Produkti Juaj HandHeld dhe hiqni të gjithë memorien e zgjerueshme, kjo e dhënë do t'i mundësohet personit i cili merr Produktin HandHeld. Nëse Produkti Juaj HandHeld iu kthehet pasi është fshirë dhe transferuar, si pas shërbimit të Produktit Tuaj HandHeld, Juve do t'ju tuhet të ri-instaloni ndonjë program i cili nuk u dërgua fillimisht me Produktin HandHeld.
- (c) Shkëputja e Pajisjes. Disa Shërbime RIM, të tilla si BlackBerry Protect dhe Shërbimi i Internetit BlackBerry, Ju lejon të shkëpusni Produktin Tuaj HandHeld nga ky Shërbim RIM. Nëse Produkti Juaj HandHeld ka humbur apo është vjedhur, Ju transferoni Produktin Tuaj HandHeld për çfarëdo arsye, ose Ju nuk dëshironi më që Produkti Juaj HandHeld të jetë i lidhur me këto Shërbime të RIM, Ju mbani përgjegjësi për shkëputjen e Produktit Tuaj HandHeld nga ky Shërbim(e) i RIM.

15. Konfidencialiteti dhe Asnjë Ndryshim Inxhinierik. Ju pranoni dhe bini dakord se BlackBerry Solution Juaj ishte: (a) zhvilluar në kohë dhe shpenzime të konsiderueshme nga RIM dhe/ose Grupi i Shoqërive të RIM;

dhe (b) që Produktet RIM, Shërbimet RIM, Programi dhe CALs në lidhje me të, duke përfshirë Produktet Beta, përmbajnë informacion konfidencial që përfshijnë sekretet tregtare të RIM, Grupin e Shoqërive të RIM dhe furnizuesit të tyre përkatës. Pa u kufizuar me sa më sipër për Produktet Beta, informacioni konfidencial përfshin pamjen e jashtme, 'shiko dhe prek', performancën, specifikimet, karakteristikat dhe funksionalitetin e programit dhe hardware, informacion i cili nuk duhet të diskutohet ose t'i tregohet publikut nga Ju ose nga përdoruesit Tuaj të Autorizuar në asnjë mënyrë, derisa të lëshohet publikisht nga RIM. Kjo marrëveshje nuk ju jep Juve asnjë të drejtë të merrni nga RIM apo filialet e tij ndonjë kod burimi për Programin, Shërbimet RIM, Artikujt e Palës së Tretë ose Shërbimet e Palës së Tretë dhe përveç për atë sa RIM është shprehimisht i kufizuar me ligj për të ndaluar këto veprime, Ju bini dakord se as Ju as Përdoruesit Tuaj të Autorizuar nuk do të ndryshoni, modifikoni, adaptoni, krijoni punë të prejardhura, përktheni, dëmtoni, apo të Ndryshoni Inxhinierinë e Programit dhe/ose CAL në lidhje me të, Shërbimet RIM, ose Artikujt e Palës së Tretë ose Shërbimet e Palës së Tretë ose tentoni të veproni kështu, ose të lejoni, pranoni në heshtje, ose të autorizoni apo inkurajoni ndonjë palë tjetër për të vepruar kështu. Për qëllimet e kësaj marrëveshje, "Ndryshimi Inxhinierik" përfshin çdo veprim të ndryshimit inxhinierik, përkthimin, çmontimin, mospërpilimin, dekriptimin, apo çmontimin (duke përfshirë çdo aspekt të "zbrazjes së RAM/ROM ose të ruajtjes së vazhdueshme", "pergjimin me kabell ose pa kabell", ose "kutinë e zezë" të ndryshimit inxhinierik) e të dhënave, programit, (duke përfshirë ndërfaqe, protokolle dhe ndonjë të dhënë tjetër të përfshirë apo të përdorur në bashkëpunim me programet që mund të konsiderohen ose jo teknikisht, kode programi) shërbimin, apo hardware ose ndonjë metodë apo proces të marrjes ose konvertimit të ndonjë informacioni, të dhënë apo programi në një formë të lexueshme.

16. Afati. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi sapo Ju të bini dakord me respektimin e kushteve dhe afateve të kësaj Marrëveshje (siç pershkruhet në parathënien e mësipërme) dhe do të vazhdojë të jetë e vlefshme përveç nëse përfundon në përputhje me dispozitat e vendosura në të.

17. Mjetet Ligjore dhe Zgjidhja për Mospagim.

Krahas të drejtave ose mjeteve ligjore të tjera të RIM të paraqitura në këtë Marrëveshje:

- (a) Nëse Ju apo Përdoruesit Tuaj të Autorizuar shkëlpi këtë Marrëveshje, RIM ose agjenti i tij, mund të, por nuk është i detyruar të, marrë masa të caktuara që ai i gjykon të përshtatshme. Këto masa mund të përfshijnë heqjen e përkohshme ose të përhershme të Përmbajtjes, bllokimin ose bllokimin e pjesshëm të transmetimit të Internetit dhe/ose pezullimin e menjëhershëm ose përfundimin e një pjese ose e të gjithë BlackBerry Solution Tuaj ose të ndonjë Artikulli të Palës së Tretë të përdorur në lidhje me BlackBerry Solution Tuaj.
- (b) Krahas të gjitha të drejtave dhe mjeteve ligjore të tjera që sigurohen nga kjo Marrëveshje ose me ligj, RIM mund të; (i) zgjidhë menjëherë këtë Marrëveshje dhe ndonjë marrëveshje tjetër licensimi ndërmjet Jush dhe RIM për ndonjë pjesë tjetër të BlackBerry Solution Tuaj të përdorur nga Ju ose Përdoruesit Tuaj të Autorizuar me Programin nëse Ju shkëlpi këtë Marrëveshje ose ndonjë Shtesë të kësaj marrëveshje që ju keni lidhur me RIM ose me një filial të RIM që përfshin, mos pagimin e komisioneve brenda (30) ditëve nga dita që ato bëhen për tu paguar; dhe/ose (ii) ndalon së ofruari Shërbime RIM për Ju ose për Përdoruesit Tuaj të Autorizuar në lidhje me BlackBerry Solution Tuaj. Kur Ju t'i keni dhënë RIM informacione të sakta kontakti, RIM do të bëjë përpjekjet tregtare të arsyeshme për t'ju dhënë njoftimin e përfundimit.
- (c) Nëse ndonjë Program BlackBerry Handled është dizenuar për t'ju lejuar akses specifik të Shërbimeve të Palës së Tretë, dhe këto Shërbime të Palës së Tretë nuk duhet t'ju ofrohen më për çfarëdo arsye, RIM mund të, por nuk është i detyruar të përfundojë licensën Tuaj për të përdorur Programin BlackBerry Handheld, në çdo kohë me ose pa njoftim; megjithatë, nëse kjo realizohet, RIM do të përdorë masat e arsyeshme komerciale për t'ju pajisur me njoftimin e përfundimit. Nëse Ju e keni paguar RIM për këtë Program BlackBerry Handheld nuk jeni në shkelje të kësaj Marrëveshjeje, Ju mund të keni të drejtën e rimbursimit të një pjese ose të gjithë shumës që i keni paguar RIM për Programin BlackBerry

Handheld, siç paraqitet në politikën e rimbursimit të RIM në atë kohë në fuqi për Programin BlackBerry Handheld. Ky rimbursim, nëse ka, do të jetë e drejta Juaj ekskluzive dhe detyrim vetëm i RIM ndaj Jush në rastin e zgjidhjes së kësaj license.

- (d) Për më tepër, RIM mund të zgjidhë këtë Marrëveshje dhe/ose të ndërpresë menjëherë ofrimin e Shërbimeve të RIM pa ndonjë detyrim të çfarëdoshëm ndaj Jush ose ndaj Përdoruesve Tuaj të Autorizuar nëse RIM i ndalohet t'ju ofrojë ndonjë pjesë ose të gjithë Shërbimin RIM me ligj, rregullore të lëshuar nga një strukturë gjyqësore apo qeveritare çfarëdo, ose nëse një njoftim nga një agjenci qeveritare ose departament tregon se RIM nuk i lejohet të japë ndonjë pjesë ose të gjithë Shërbimin RIM. Asgjë këtu nuk do të interpretohet si kërkesë që RIM të heqë dorë nga ndonjë ligj i tillë, rregull, rregullore ose kufizim ose të kërkojë shqyrtim gjyqësor ose apelim me vendim gjykate. Nëse është e mundur, RIM do të përdorë përpjekjet e arsyeshme për t'ju dërguar njoftim paraprak (30) ditë para përfundimit ose ndërprerjes në rastin e Shërbimeve të Paguara të RIM.
- (e) Përveç nga sa parashikohet shprehimisht këtu, RIM nuk do të ketë detyrime ndaj Jus apo Përdoruesve Tuaj të Autorizuar nga ose në lidhje me përfundimin e kësaj Marrëveshjeje, ose ndonjë të drejtë ose licensë që jepet këtu në lidhje me këtë Marrëveshje.
- (f) Çdo zgjidhje sipas kësaj Marrëveshjeje nga RIM do të marrë efekt pa qenë e nevojshme që RIM të marrë ndonjë miratim gjyqësor ose administrativ, aprovim ose zgjidhje të çfarëdoshme në juridiksionin Tuaj.
- (g) Nëse Ju shkelni, shpërdoroni ose ndryshe prishni informacionin konfidencial të RIM, pronësinë intelektuale ose të drejta të tjera pasurore (së bashku, "Shkelja e Pronësisë Intelektuale") dhe një gjykatë në Shqipëri nuk është në gjendje apo nuk ka ndërmend të japë një vendim gjyqësor për të ndaluar këtë Shkelje të Pronësisë Intelektuale, Ju pranoni se RIM do të ketë të drejtë të marrë dëmet e likuiduara nga Ju në shumën prej 5,000 Dollarë Amerikanë në ditë gjatë periudhës së kësaj shkelje të Pronësisë Intelektuale.

18. Pasoja e Zgjidhjes Me zgjidhjen e kësaj Marrëveshjeje ose ofrimit të ndonjë Shërbimi RIM tek Ju, pavarësisht si është shkaktuar, ose nëse abonimi Juaj ose periudha e përdorimit falas për Programin ose ndonjë Shërbim RIM skadon, ose Periudha e Testimit për Produktet Beta skadon ose ka mbaruar: (a) Ju do të ndërprisni menjëherë çdo përdorim të Programit dhe të Shërbimeve RIM, ose në rastin kur kjo Marrëveshje nuk ka përfunduar, artikulli (ose artikujt) e Programit për të cilin licënca ose në rastin e Shërbimeve RIM ofrimi i këtij Shërbimi RIM, ka përfunduar ose skaduar, dhe të ktheni të gjitha kopjet e këtij Programi dhe në rastin e Produkteve Beta të gjitha Hardware Beta, që janë në posedimin ose kontrollin Tuaj dhe/ose të Përdoruesve Tuaj të Autorizuar; dhe (b) RIM do të ketë të drejtën të bllokojë transmetimin e të dhënave tek dhe nga ky Program dhe/ose Shërbimi RIM, pa ju njoftuar. Me përfundimin e çdo llogarie që Ju mund të keni me RIM, Ju autorizoni RIM të fshijë çdo skedar, program, të dhëna dhe mesazhe elektronike të lidhura me këtë llogari, pa ju njoftuar. Ju mbani përgjegjësi për të gjitha shumat që janë për tu paguar duke përfshirë datën efektive të përfundimit në lidhje me Programin, Shërbimet RIM dhe Artikujt e Palës së Tretë, duke përfshirë shumat që i ngarkohen mënyrës së pagesës që ju keni Autorizuar. Pavarësisht nga sa më sipër, për shkak të natyrës së Programit, mund të jetë e pamundur për të kthyer Programin për shkak se Programi është i integruar në hardware-in që keni në pronësi (të tilla si një Produkt Handheld) dhe/ose Programi mund të jetë i instaluar në një desktop apo një server të tillë që gjithçka që ju mund të ktheni është një riprodhim i mëtejshëm i Programit. Në raste të tilla, jeni te lutur te kontaktoni RIM në [legalinfo@rim.com](mailto:legalinfo@rim.com) për udhëzime të mëtejshme.

19. Dëmshpërblimi/Përgjegjësia. Ju duhet të dëmshpërbleni, dhe të ruani të padëmtuar RIM, Shoqëritë e Grupit të RIM, filialet e RIM, furnizuesit, trashëgimtarët, agjentët, distributorët e autorizuar (duke përfshirë

Ofruesit e Shërbimit Airtime) dhe të ngarkuarit dhe çdonjërin prej drejtorëve, zyrtarëve, nëpunësve dhe kontraktuesve të pavarur (secili një "Palë e Dëmshpërblyer e RIM") nga ndonjë dëmtrim, humbje, kosto apo shpenzime (duke përfshirë, pa kufizim, pagesat dhe shpenzimet e arsyeshme për avokatët) të pësuar nga një Palë e Dëmshpërblyer e RIM dhe me kërkesën të Palës së Dëmshpërblyer të RIM, të mbronin me shpenzimet Tuaja çdo pretendim të ndonjë pale të tretë ose proedim që ngrihet kundër Palës së Dëmshpërblyer RIM, si rrjedhojë e : (a) shkeljes së patentave apo të ndonjë të drejtë tjetër të pronësive intelektuale apo të drejtë pasurore për shkak të kombinimit apo përdorimit të ndonjë pajisjeje (të ndryshme nga një Produkt Handheld), sistemi ose shërbimi që lidhet BlackBerry Solution Tuaj apo ndonjë pjesë të tij; ose (b) shkeljes nga ana Juaj e kësaj Marrëveshjeve ose e ndonjë Shtese të kësaj Marrëveshjeje. Asnjë mjet ligjor që diskutohet këtu për RIM nuk synon të jetë, dhe as nuk do të interpretohet të jetë, përjashtimor nga mjetet e tjera ligjore të paraqitura këtu ose siç lejohet me ligj ose të drejtën zakonore, por të gjitha këto mjete ligjore do të jenë kumulative.

## 20. Garancitë e Kufizuara.

### (a) Programi.

- (i) Nëse gjatë një periudhe (90) ditore pas shpërndarjes së Programit tek Ju ("Periudha e Garancisë"), Programi i mundësuar nga RIM apo ndonjë distributor i autorizuar i RIM nuk është në gjendje të kryejë funksionet e përshkruara në Dokumentacionin standard të përdoruesit fundor ("Specifikimet") kur përdoret siç është specifikuar nga RIM në Dokumentacionin e aplikueshëm për llojin dhe versionin specifik të Programit në lidhje me pjesët e tjera të pandryshueshme të BlackBerry Solution Tuaj, RIM në zgjedhjen dhe gjykimin e vetë, ose do të bëjë përpjekje për të korrigjuar ose për t'ju dhënë një zgjidhje të këtij problemi (rregullim ose riparim i cili mund t'ju ofrohet sipas gjykimit të arsyeshëm të RIM në një nga format e shumëllojshme, duke përfshirë rrjedhën e mbështetjes së klientit që ju është ofruar përmes e-mail ose telefonit, në një program të vënë përgjithësisht në dispozicion, në faqen e internetit të RIM ose në ndonjë formë tjetër të cilën RIM Jua këshillon) ose Ju rimbursor për tarifat e paguara njëherë nga Ju për Programin e aplikueshëm nëse Ju ndërprisni përdorimin e Programit dhe mjetet në të cilat Programi Ju është dhënë, dhe të gjitha paketat në lidhje me të i kthehen RIM në përputhje me mekanizmin e kthimit normal të garancisë Tuaj (që mund të jetë përmes Ofruesit Tuaj të Shërbimit Airtime, nëse është i aplikueshëm, ose në pikën e shitjes) brenda Periudhës së Garancisë së bashku me provën e blerjes.
- (ii) Pavarësisht nga çdo gjë që bie në kundërshtim me këtë Marrëveshje, azhornimet, dhe përmirësimet që Ju janë ofruar falas janë dhënë "Siç Është" dhe pa asnjë lloj garancie.
- (iii) Azhornimet dhe Përmirësimet, për të cilat Ju keni paguar tarifat shtesë të licencës do të jenë objekt i garancisë të vendosur më sipër për një periudhë nëntëdhjetë (90) ditore që prej datës që ky përmirësim për çdo Program ju është dhënë Juve.
- (iv) Detyrimi i mësipërm nuk do të zbatohet nëse mosfunksionimi i Programit për të kryer funksionet e përshkruara në Specifikime vjen si pasojë e : (A) Përdorimit të Programit në mënyrë kontraktore me çdo detyrim Tuajin të përshkruar në këtë Marrëveshje ose në një mënyrë që bie në kundërshtim me udhëzimet, duke përfshirë udhëzimet e sigurisë të specifikuara nga RIM në Dokumentacionin e zbatuar për llojin dhe versionin specifik të Programit; ose (B) një keqfunksionim ose problem tjetër që lidhet me ndonjë hardware (duke përfshirë ato që burojnë nga Produktet Handheld të Palës së Tretë), rrjet, program dhe sistem komunikimi (riparimet e Pajisjeve Difektoze BlackBerry i nënshtrohen marrëveshjeve të garancisë dhe/ose suportit për ato

Produkte të RIM); ose (C) çdo shkak të jashtëm që prek Programin, duke përfshirë mediat ku shfaqet Programi, të tilla si aksident, katastrofë, shkarkim elektrostatik, zjarr, përmytje, vetëtimë, ujë ose erë, korrigjim i gabimeve që i atribuohen programeve të tjera nga Programi, ose defekte për shkak të riparimeve ose modifikimeve të pa-autorizuara nga RIM.

- (v) Për sqarim, përveç nëse kërkohet ndryshe nga ligji në fuqi, kjo garanci vlen për Programin BlackBerry Handheld në Produktet e reja Handheld, dhe nuk zbatohet për Programin BlackBerry Handheld të përfshirë me Produktet Handheld të përdorura apo të rinovuara.
  - (vi) Nuk ka garanci për shkarkime falas nga tregu i artikujve shtesë të Programit, ose për Programin falas të Serverit BlackBerry. Nëse ndonjë pikë e këtij Programi nuk funksionon në përputhje me Dokumentacionin e saj brenda nëntëdhjetë (90) ditëve pas datës që Ju e instaloni atë në Produktin Tuaj Handheld apo në kompjuter sipas rastit, Ju mund të kontaktoni RIM dhe RIM do të identifikojë mbështetjen e mundshme, nëse ka, për këtë Program (mbështetje e cila mund t'Ju ofrohet me vendim të RIM në një nga format e ndryshme, duke përfshirë këtu mbështetjen e klientit me telefonatë dhe e-maile, zhbllokimin dhe rregullimin e programit të vënë përgjithësisht në dispozicion, në faqen e internetit të RIM ose në ndonjë formë tjetër të cilën RIM Jua këshillon).
  - (vii) Ju pranoni dhe bini dakord që aty ku ky Program është projektuar për të lehtësuar aksesin Tuaj në Artikujt e Palës së Tretë ose në Shërbimet e Palës së Tretë, RIM MUND TË KETË KONTROLL TË KUFIZUAR OSE JO MBI FUNKSIONALITETIN, PËRMBUSHJEN OSE MOS-PËRMBUSHJEN E KËTYRE ARTIKUJVE TË PALËS SË TRETË OSE SHËRBIMEVE TË PALËS SË TRETË, DHE MUND TË MOS JETË NË GJENDJE TË OFROJË RREGULLIMIN OSE RIPARIMIN E NJË PROBLEMI QË JU IDENTIFIKONI ME KËTË PROGRAM. RIM nuk garanton Artikujt e Palës së Tretë ose Shërbimet e Palës së Tretë, dhe në lidhje me këto, Ju duhet të kërkoni tek ofruesi i këtyre shërbimeve të Artikullit të Palës së Tretë ose të Shërbimit të Palës së Tretë për një garanci. Garancitë variojnë ndërmjet ofruesve dhe juridiksioneve për një ofrues të veçantë. Ju duhet t'i referoheni dokumentacionit përkatës ose kushteve të ofruesit për të gjetur se çfarë mbështetje po jep një ofrues për një artikull të veçantë ose për shërbimet e tij dhe të drejtat Tuaja në lidhje me mbështetjen dhe garancitë.
  - (viii) Ky Seksion përcakton detyrimet e vetme të RIM dhe kompensimin Tuaj të vetëm në lidhje me Programin dhe çdo defekt, gabim, problem, ose shkelje të garancisë për Programin e përcaktuar këtu.
- (b) Produkt(et). Garancia e kufizuar, nëse ka, për produkt(et) RIM ("Garancia e Kufizuar e Produktit") është përcaktuar në Dokumentacionin e zbatueshëm. Garancia e Kufizuar e Produkteve është garancia ekskluzive për çdo Produkt RIM të shitur sipas kushteve të kësaj Marrëveshje dhe përcakton kompensimet Tuaja në lidhje me produktet RIM dhe çdo shkelje të Garancisë së Kufizuar të Produktit. Beta Hardware jepet "Siç Është" dhe pa garanci të çfarëdo lloji. Nën-pikat e mëposhtme të Seksionit të kësaj Marrëveshje të titulluara "Të përgjithshme" (Pika 29) më poshtë janë përfshirë duke iu referuar kushteve të Garancisë së Kufizuar të Produktit, e modifikuar sipas kërkesës për aq sa është e nevojshme për tu aplikuar në Garancinë e Kufizuar të Produktit: "Heqja dorë nga Mospërmbushja e detyrimeve" (Seksioni 29(b)), "Lënia në Fuqi" (Seksioni 29(c)), "Veçeshmëria" (Seksioni 29(e)), "Gjuha" (Seksioni



29(f) dhe "Marrëveshja në Tëresi" (Seksioni 26(h)). Duke dhënë pranimin Tuaj të kësaj Marrëveshje siç është paraqitur më sipër, Ju pranoni se keni lexuar Garancinë e Kufizuar të Produktit dhe bini dakord me kushtet e saj. Për sqarim, për aq sa kërkohet nga ligji në fuqi, "Garancia e Kufizuar e Produktit" zbatohet vetëm për Produkt(et) e reja të RIM dhe vetëm teprica e kësaj garancie (nëse ka), zbatohet mbi Produkt (et) e rinovuar të RIM.

21. Mbështetja Pas mbarimit të Garancisë. Nëse Ju dëshironi të merrni mbështetje nga RIM pas mbarimit të periudhës së garancisë, jeni të lutur të kontaktoni RIM në sales@BlackBerry.com (ose mjedise të tjera të listuara në <http://www.BlackBerry.com/legal/>) ose Ofruesin Tuaj të Shërbimit Airtime. Nëse Ju keni një palë të tretë që drejton Programin në emrin Tuaj (një "Palë Drejtuese") dhe Ju dëshironi që Pala Drejtuese të marrë mbështetje për Programin nga RIM në emrin Tuaj, atëherë qoftë Ju ose Pala Drejtuese duhet të keni një marrëveshje mbështetjeje me RIM për Artikuj të veçantë të Programit siç kërkohet për numrin Tuaj të Përdoruesve të Autorizuar, dhe Ju duhet të azhornoni RIM herë pas here për sa i përket Programit të drejtuar në emrin Tuaj duke dërguar një e-mail tek sales@BlackBerry.com (ose në vënde të tjera të listuara <http://www.BlackBerry.com/legal/>) duke identifikuar Programin, numrin e kopjeve që Ju keni licënsuar, së bashku me SRP-ID dhe CALs. Asistenca për BlackBerry Solution Tuaj mund të mos mundësohet përmes disa Ofrues të Shërbimit Airtime.

## 22. Refuzimi.

LEGJISLACIONI I DISA JURIDIKSIONEVE MUND TË MOS LEJOJË KUFIZIMIN E PËRGJEGJËSISË OSE PËRJASHTIMIN E GARANCIVE, KUSHTEVE, MIRATIMEVE, SIGURIMEVE OSE DEKLARIMEVE NË KONTRATAT ME KONSUMATORËT DHE PËR AQ SA JU JENI KONSUMATORË, KËTO PËRJASHTIME MUND TË MOS APLIKOHEN PËR JU.

### (a) Garancitë e Përgjithshme

- (i) DERI NË KUFIJTË MAKSIMALE TË LEJUAR SIPAS LEGJISLACIONIT TË ZBATUESHËM, ME PËRJASHTIMET E PËRCAKTUARA SHPREHIMISHT NË KETË MARRËVESHJE, TË GJITHA KUSHTET, MIRATIMET, GARANCITË, DEKLARIMET, OSE GARANCITË E ÇFARËDO LLOJI, TË SHPREHURA OSE TË NËNKUPTUARA, DUKE PËRFSHIRE ÇDO KUSHT, MIRATIM, GARANCI, DEKLARIM OSE GARANCI TË QËNDRUESHMËRISË, TË PËRSHTATSHMËRISË PËR NJË QËLLIM OSE PËRDORIM TË CAKTUAR, TË SHITJES, TË CILËSISË SË SHITJES, TË MOS SHKELJES, TË CILËSISË SË KËNAQSHME, OSE TË TITULLIT, OSE QË RRJEDHIN NGA STATUTI OSE ZAKONI OSE NEGOCIMET PARAPRAKE OSE ZAKONET TREGTARE, DHE TË GJITHA GARANCITË E TJERA, DEKLARIMET, KUSHTET, MIRATIMET OSE GARANCITË E ÇFARËDOLLOJI QOFTË, TË SHPREHURA APO TË NËNKUPTUARA, JANË TË REFUZUARA DHE TË PËRJASHTUARA .
- (ii) Deri në kufijtë maksimale të lejuara sipas ligjit të zbatueshëm, të gjitha garancitë e nënkuptuara ose kushtet e lidhura me Programin për aq sa ato nuk mund të përjashtohen siç është përcaktuar më lart, por mund të kufizohen, do të kufizohen për nëntëdhjetë (90) ditë që nga dita e parë që Ju keni instaluar ndonjë pjesë të Tuajit BlackBerry Solution në çdo kompjuter.

### (b) Shërbimi(et) e RIM.

- (i) PËRVEÇ RASTEVE TË NDALUARA NË MËNYRË SPECIFIKE NGA LIGJI I ZBATUESHËM, ÇDO SHËRBIM I RIM OFROHET OSE BËHET I AKSESUESHËM "SIÇ ËSHTË" DHE "SIÇ MUNDËSOHET", PA KUSHTE, MIRATIME, DEKLARIME OSE GARANCI TË ÇDO LLOJI NGA RIM, SIÇ PARASHIKOHET NE SEKSIONIN 23(B), RIM NUK DO TË KETË

PËRGJEGJËSI TË ASNJË LLOJI KUNDREJT JUSH, OSE NDONJË PALE TË TRETË E CILA PRETENDON NGA OSE NËPËRMJET JUSH, PËR NJË CËSHTJE QË LIDHET ME NDONJË SHËRBIM TË RIM I CILI NUK ËSHTË SHËRBIM I RIM I PAGUAR.

- (ii) PËRVEÇ RASTEVE TË NDALUARA NË MËNYRË SPECIFIKE NGA LIGJI I ZBATUESHËM, RIM NUK GARANTON APO OFRON NJË SIGURIM TJETËR TË NGJASHËM TË ÇFARËDOLLOJI QË PAVARËSISHT PËRDORIMIT TË PANDËRPRERË OSE OPERIMIT TË ÇDO SHËRBIMI TË RIM, VAZHDIMËSISË SË VLEFSHMËRISË SË ÇDO SHËRBIMI TË RIM, OSE QË ÇDO MESAZH, PËRMBAJTJE OSE INFORMACION QË ËSHTË DËRGUAR NGA JU OSE TEK JU ISE I RUAJTUR NGA OSE NË EMRIN TUAJ, NUK DO TË HUMBASË, FSHIHET OSE KORRUPTOHET OSE DO JETË KORREKT, I TRANSMETUAR NË FORMË TË PAKORRUPTUAR OSE BRENDA NJË PËRIUDHE KOHE TË ARSYESHME.

(c) Artikujt e Palës së Tretë dhe Shërbimet e Palës së Tretë, Faqet e internetit të lidhura.

- (i) PËRVEÇ RASTEVE TË NDALUARA NË MËNYRË SPECIFIKE NGA LIGJI I ZBATUESHËM, SHËRBIMET E PALËVE TË TRETA DHE ARTIKUJT E PALËVE TË TRETA NUK JANË NË KONTROLLIN E RIM, RIM NUK APROVON NDONJË ARTIKULL TË VEÇANTË TË PALËS SË TRETË APO SHËRBIM TË PALËS SË TRETË, DHE RIM NUK KA ASNJË PËRGJEGJËSI CILA DO QOFTË AJO PËR ZGJEDHJEN TUAJ, PËRDORIMIN, AKSESIN, APO IMPLEMENTIMIN TË SHËRBIMEVE OSE ARTIKUJVE TË PALËS SË TRETË.
- (ii) SA MË SIPËR ZBATOHET PAVARËSISHT: (A) SI KENI PËRFITUAR APO SI KENI MARRË AKSES NË ARTIKUJT E PALËS SË TRETË DHE/OSE NË SHËRBIMET E PALËS SË TRETË, ME FJALË TË TJERA, OSE NË MËNYRË TË PAVARUR, OSE NDËRMJET RIM APO FURNIZUESIT TUAJ AIRTIME, (B) NËSE NDONJË NGA ARTIKUJT E PALËS SË TRETË OSE SHËRBIMET TË PALËS SË TRETË (DUKE PËRFSHIRË SHËRBIMET AIRTIME) JANË TË NEVOJSHME NË MËNYRË QË TË PËRDORNI TË GJITHE OSE NDONJË PJESË TË TUAJIT BLACKBERRY SOLUTION; OSE (C) NËSE JU KENI MARRË OSE PËRFITUAR AKSES NË KËTO ARTIKUJ TË PALËS SË TRETË DHE SHËRBIME TË PALËS SË TRETË ME ATË TË PRODUKTIT HANDHELD, DUKE PËRFSHIRË PA KUFIZIM, NËPËRMJET SHFLETUESIT OSE PROGRAMIT TË MAGAZINËS RIME QË MUND TË JEPET SI PJESE E PROGRAMIT TË BLACKBERRY HANDHELD, NËPËRMJET SHKARKIMIT PAS TREGTIMIT TË PROGRAMIT BLACKBERRY HANDHELD QË LEHTËSON AKSESIN TUAJ NË SHËRBIMET SPECIFIKE TË PALËS SË TRETË DHE/OSE ARTIKUJT E PALËS SË TRETË, APO NËPËRMJET LIDHJEVE TEK PROGRAMI I PALËS SË TRETË OSE FAQE INTERNETI TË PALËS SË TRETË DHE/OSE SHËRBIME TË PALËS SË TRETË QË JU JANË MUNDËSUAR NËPËRMJET IKONAVE OSE FLETSHËNUESVE NË PRODUKTIN TUAJ HANDHELD, APO ME ÇFARËDOLLOJI MËNYRE QOFTË, DUKE PËRFSHIRË FAQET E TJERA TË INTERNETIT OSE NDËRMJET INFORMACIONIT TË MARRË DUKE PËRDORUR PRODUKTIN TUAJ HANDHELD OSE TË OFRUARA NGA RIM OSE NJË FURNIZUES SHËRBIMI AIRTIME.
- (iii) DUKE MOS U KUFIZUAR NGA SA MË SIPËR, PËRVEÇ RASTEVE TË NDALUARA NË MËNYRË SPECIFIKE NGA LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM, TË GJITHË ARTIKUJT E PALËS SË TRETË DHE SHËRBIMET E PALËS SË TRETË JANË DHËNË OSE JANË BËRË TË

AKSESUESHME NGA RIM, OSE TË PËRDORURA NË NËJ MËYRË TJETËR NGA JU SËBASHKU ME BLACKBERRY SOLUTION, MBI BAZËN "SIÇ ËSHTË" DHE "SIÇ MUNDËSOHET", PA ASNJË KUSHT, MIRATIM, DEKLARIM APO GARANCI TË NDONJË LLOJI, DHE RIM NUK KA ASNJË PËRGJEGJËSI KUNDREJT JUSH OSE NDONJË PALË TË TRETË QË PRETENDON NGA JU OSE NËPËRMJET JUSH, PËR NDONJË ÇËSHTJE NË LIDHJE ME ARTIKUJT E PALËVE TË TRETË, OSE SHËRBIMET E PALËVE TË TRETË, PËRFSHIRË: (A) SAKTËSINË, TRANSMETIMIN, MUNDËSINË APO DISPONUESHMËRINË E VAZHDUESHME TË KËTYRE ARTIKUJVE TË PALËS SË TRETË, OSE SHËRBIMEVE TË PALËS SË TRETË, APO TË NDONJË PJESE TË PROGRAMIT TË PROJEKTUAR VETËM PËR TË MUNDËSUAR NJË AKSES TË TILLË; (B) ZBATIMIN OSE JO TË ARTIKUJVE TË PALËS SË TRETË, OSE SHËRBIMEVE TË PALËS SË TRETË; OSE (C) NDËRVEPRIMIN E ARTIKUJVE TË PALËVE TË TRETË, OSE SHËRBIMEVE TË PALËVE TË TRETË ME TË GJITHË OSE ME NJË PJESË TË TUAJIT BLACKBERRY SOLUTION; OSE (D) VEPRIMET OSE MOSVEPRIMET E NDONJË PALE TË TRETË NË LIDHJE ME ARTIKUJT E PALËS SË TRETË OSE SHËRBIMET E PALËS SË TRETË, DUKE PËRFSHIRË NË LIDHJE ME PËRDORIMIN NGA NJË PALË E TRETË E TË DHËNAVE TUAJA.

(iv) DUKE MOS U KUFIZUAR NGA SA MË SIPËR, PËRVEÇ RASTEVE TË NDALUARA NË MËNYRË SPECIFIKE NGA LIGJI I ZBATUESHËM, JU BINI DAKORT NË MËNYRË TË SPECIFIKE QË RIM NUK ËSHTË I DETYRUAR OSE PËRGJEGJËS PËR, NDONJË VIRUS, OSE NDONJË KËRCËNIM, SHPIFJE, PAHIJËSHMËRI, KUNDËRLIGJSHMERI, OFENDIM OSE SHËRBIME TË PALIGJSHME TË PALËVE TË TRETË, ARTIKUJ TË PALËVE TË TRETË OSE PËR ÇDO ARTIKULL TË PALËVE TË TRETË OSE SHËRBIM TË PALËVE TË TRETË OSE TRANSMETIM TË TYRE, QË CËNON ÇDO TË DREJTË PRONËSIE INTELEKTUALE TË PALËVE TË TRETË. REKURSI JUAJ NË RASTIN E NDONJË PRETENDIMI TË TILLË, NË LIDHJE ME NDONJË ARTIKULL TË PALËVE TË TRETË, OSE SHËRBIM TË PALËVE TË TRETË, DO TË JETË VETËM KUNDËR PALËVE TË TRETË PËRKATËSE.

(d) Aplikimet me Mision Kritik.BLACKBERRY SOLUTION JUAJ DHE ÇDO PJESË E TIJ, NUK ËSHTË I PËRSHTATSHËM PËR TU PËRDORUR NË APLIKIMET ME MISION KRITIK OSE NË MJEDISËT ME RREZIK TË CILAT KËRKOJNË KONTROLL OSE PERFORMANCË SIGURIE, QË PËRFSHIJNË OPERIMIN E PAJISJEVE NUKLEARE, NAVIGACIONIN AJROR OSE SISTEMET E KOMUNIKIMIT, KONTROLLIN E TRAFIKUT AJROR, MBËSHTJETJEN E JETËS, SISTEMET E ARMEVE OSE GJURMUESIT E EMERGJENCËS OSE SHERBIME TË TJERA EMERGJENCE. JU DEKLARONI DHE GARANTONI SE DO TË MBANI SISTEME REKUPERIMI TË DHËNASH DHE SISTEME MBËSHTETËSE TË MJAFTUESHME, DHE NË RASTIN E: (i) PËRDORIMIT OSE NDËRPRERJES SË SHËRBIMIT; OSE (ii) VËSHTIRËSIVE OSE GABIMEVE NË TRANSMETIMIN E TË DHËNAVE; OSE (iii) HUMBJEVE OSE KORRUPTIMIT TË TË DHËNAVE; JU BINI DAKORT QË MENJËHERË: TË ZVOGËLONI TË GJITHA HUMBJET OSE DËMTIMET DHE TË RAPORTONI KËTO ÇËSHTJE TË RIM. PA U KUFIZUAR REFUZIMIN E PËRGJITHSHËM TË DËMËVE NË SEKSIONIN 23(a), NË ASNJË RAST RIM NUK DO TË JETË PËRGJEGJËS PËR NDONJË DËM QË REZULTON NGA PËRDOIMI JUAJ I BLACKBERRY SOLUTION TUAJ, OSE NDONJË PALË TJETËR NË TË, PËR APLIKIMET MISSION CRITICAL OSE NË MJEDISËT ME RREZIK OSE MJEDISËT QË KËRKOJNË KONTROLLE OSE PERFORMANCA SIGURIE, EDHE SIKUR KËTO DËME TË ISHIN PARASHIKUAR

OSE JO, EDHE SIKUR RIM TË ISHTE KËSHILLUAR PËR MUNDËSINË E DËMEVE TË TILLA.

- (e) Produktet Beta. PRODUKTET BETA MUND TË MOS LEJOHEN PËR PËRDORIM NGA PUBLIKU I GJERË APO TË CERTIFIKOHEN SI PËRMBUSHËS TË RREGULLAVE OSE STANDARTEVE TË SHPALLUARA NGA QEVERIA OSE AUTORITETE TË TJERA NË JURIDIKSIONIN TUAJ, DHE RIM NUK BËN ASNJË DEKLARATË SE KËTO AUTORIZIME OSE CERTIFIKATA DO TË MERREN. SI RRJEDHIM, JU BINI DAKORT SE PRODUKTET BETA NUK JANË, DHE NUK MND TË OFROHEN PËR SHITJE OSE DHËNË ME QIRA, OSE TË SHITEN OSE JEPEN ME QIRA, DERISA KËTO AUTORIZIMI TË MERREN. PRODUKETE BETA NK KANË SI QËLLIM PËRDORIMIN NË NDONJË MJEDIS PRODUKTIV OSE MJEDIS TJETËR KU JU MBËSHTETENI NË PERFORMANCËN E PRODUKTEVE BETA. PRODUKTET BETA JANË VERSIONE TË NXJERRA PARA-TREGTARE TË PROGRAMIT, SHËRBIMEVE DHE PRODUKTEVE TË RIM DHE NUK JANË SYNUAR TË PËRFAQËSOJNË OSE PERFORMOJNË NË TË NJËJTËN MËNYRË SI PRODUKTI APO SHËRBIMET TREGTARE, DHE JU DUHET TË SIGUROHENI QË JU RREGULLISHT MBËSHTESNI ÇDO TË DHËNË TË PËRDORUR ME KËTO MATERIALE. NË VIJIM, PRODUKTET BETA PËRMBAJNË KARAKTERISTIKA FUNSKIONALITETE, OSE APIS, PËR PROGRAMIN OSE SHËRBIMET QË NUK JANË AKOMA DISPONUESHME NË TREG. JU PRANONI SE KËTO PRODUKTE BETA, OSE NDONJË PJESË E TYRE, MUND TË MOS SHPALLET APO TË JETË E DISPONUESHME NË TREG NGA RIM NË TË ARDHMEN, OSE MUND TË BËHET E DISPONUESHME ME NDRYSHIME TË KONSIDERUESHME, DHE RIM NUK KA ASNJË PËRGJEGJËSI TË SHPREHUR OSE NËNKUPTUAR KUNDREJT JUSH PËR TË SHPALLUR OSE PËR TË MUNDËSUAR PËR JU KËTO PROGRAME OSE SHËRBIME, PRODUKTET BETA OSE PJESË TË TYRE. JU PRANONI DHE BINI DAKORT QË TË GJITHA TESTIMET, VLERËSIMET DHE ZHVILLIMET QË JU KRYENI NË LIDHJE ME PRODUKTET BETA DHE PROGRAMIN DHE SHËRBIMET E LIDHURA ME TO BËHET TËRËSISHT NËN PËRGJEGJËSINË TUAJ.

23. Kufizimi i Përgjegjësise.

DISA SHTETE NUK LEJOJNË KUFIZIMIN OSE PËRJASHTIMIN E DËMEVE KONSEKUENTE, INDIREKTE APO DËMEVE TË TJERA NË KONTRATAT ME KONSUMATORËT DHE PËR AQ SA JU JENI NJË KONSUMATOR, KUFIZIMET OSE PËRJASHTIMET NË KËTË SEKSION MUND TË MOS ZBATOHET PËR JU.

- (a) DERI NË MASËN MAKSIMALE TË LEJUAR SIPAS LIGJIT NË FUQI, DHE DUKE QËNË SUBJEKT I KOMPENSIMEVE TË VECANTA TË PARASHIKUARA NË KETË MARRËVESHJE, NË ASNJË RAST RIM NUK DO TË JETË PËRGJEGJËS PËR NDONJË PREJ TIPEVE TË MËPOSHTME TË DËMEVE: KONSEKUENTE, SHËMBULLORE, AKSIDENTALE, INDIREKTE, SPECIALE, NDËSHKIMORE, MORALE OSE DËMEVE TË RËNDUARA, DËMEVE NGA HUMBJA E FITIMEVE OSE TË ARDHURAVE TË BIZNESIT, DËSHTIMI PËR TË REALIZUAR ÇDO TË ARDHUR TË PRITUR, NDËRPRERJE TË BIZNESIT, HUMBJE TË INFORMACIONIT TË BIZNESIT, HUMBJE TË MUNDËSISË SË BIZNESIT, OSE KORRUPSIONI OSE HUMBJE TË TË DHËNAVE, OSE THYERJE TE SIGURISË SË TË DHËNAVE, DËSHTIMI PËR TË TRANSMETUAR OSE PËR TË MARRË NDONJË TË DHËNË, PROBLEME TË LIDHURA ME ÇDO APLIKIM TË PËRDORUR, NË LIDHJE ME BLACKBERRY SOLUTION TUAJ, OSE QË REZULTOJNË NGA NDRYSHIMET OSE

NDRYSHIMET E SYNUARA PËR BLACKBERRY SOLUTION TUAJ, OSE NDONJË PJESË TË TYRE, NGA KUSHDO PËRVEC RIM, SHPENZIME JOPRODUKTIVE, HUMBJE TË PËRDORIMIT TË TUAJIT BLACKBERRY SOLUTION OSE NDONJË PJESE TË TIJ OSE TË SHËRBIMEVE TË PALËVE TË TRETA OSE ARTIKUJVE TË PALËVE TË TRETA, KOSTOJA E ZËVENDËSIMIT TË MALLRAVE, KOSTOT E MBULIMIT, MJETET OSE SHËRBIMET, KOSTOJA E KAPITALIT, OSE HUMBJET E TJERA TË NGJASHME NË PARA QË DALIN NGA APO NË LIDHJE ME KËTË MARRËVESHJE APO BLACKBERRY SOLUTION TUAJ DUKE PËRFSHIRË PËRDORIMIN OSE PAAFTËSINË PËR TË PËRDORUR, PERFORMUAR OSE JO TË BLACKBERRY SOLUTION TUAJ, NËSE KËTO DËME ISHIN OSE JO TË PARASHIKUARA APO TË PAPANASHIKUARA, EDHE NËSE RIM ESHTË KËSHILLUAR PËR MUNDËSINË E KËTYRE DËMEVE.

- (b) Deri në kufirin maksimal të lejuar sipas ligjit të zbatueshëm, në asnjë rast përgjegjësia totale e RIM do të tejkalojë: (i) shumën e paguar nga Ju për Produktin(et) e RIM sipas rastit; (ii) shumën e paguar për atë pjesë të Programit sipas rastit; (iii) shumën e paguar për periudhën përkatëse të Shërbimit RIM të Paguar sipas rastit; dhe (iv) pesë (5) dollarë Amerikanë.
- (c) Deri në kufirin maksimale të lejuar sipas ligjit të zbatueshëm, deri në masën që RIM është përgjegjës ndaj Jush sipas kësaj Marrëveshje, RIM do të jetë përgjegjës vetëm për dëmet e shkaktuara gjatë periudhës të këtij dështimi, vonese apo mos-performance të BlackBerry Solution Tuaj.
- (d) Asgjë në këtë Seksion, nuk kufizon përgjegjësitë e RIM ndaj Jush në rast vdekje ose dëmtimi trupor për aq sa rezulton direkt nga neglizhenca e RIM; duke patur parasysh se çdo dëm i pagueshëm nga RIM do të reduktohet me kontributin Tuaj ose të tjerëve.
- (e) DERI NË KUFIRIN MAKSIMALE TË LEJUAR SIPAS LIGJIT TË ZBATUESHËM, ÇDO PALË DO TË KETË PËRGJEGJËSI KUNDREJT TJETRËS VETËM SIÇ ËSHTË PARASHIKUAR SHPREHIMISHT NË KËTË MARRËVESHJE DHE NUK DO TË KETË ASNJË DETYRIM TJETËR, DETYRË, OSE PËRGJEGJËSI TË ÇDOLLOJI QOFTË NË KONTRATË, SHKELJE CIVILE OSE TJETËR.
- (f) DERI NË MASËN MAKSIMALE TË LEJUAR SIPAS LIGJIT TË ZBATUESHËM, KUFIZIMET, PËRJASHTIMET, DHE REFUZIMET NË KËTË MARRËVESHJE DO TË: (i) ZBATOHEN PAVARËSISHT NGA NATYRA E SHKAKUT TË VEPRIMIT, KËRKESËS OSE VEPRIMIT NGA JU, DUKE PËRFSHIRE, POR PA U KUFIZUAR NË, NEGLIZHENCË, SHKELJE CIVILE, PËRGJEGJËSI TË RREPTË, SHKELJE TË KONTRATËS, OSE NDONJË TEORI TJETËR LIGJORE; (ii) JENË NË FUQI MBI ÇDO SHKELJE THELBËSORE OSE DËSHTIM TË QËLLIMIT THELBËSOR TË KËSAJ MARRËVESHJEJE OSE TË NDONJË KOMPENSIMI TË PËRFSHIRË NË KËTË MARRËVESHJE, (iii) JENË TË PA ZBATUESHME PËR DETYRIMET E DËMSHPËRBLIMIT TË PËRCAKTUARA NË KËTË MARRËVESHJE OSE SHPËRDORIMET OSE SHKELJET NGA CILADO PALË PËR PRONËSINË INTELLEKTUALE TË PALËS TJETËR, OSE PËR NJË SHKELJE TË SEKSIONEVE TË KËSAJ MARRËVESHJEJE TË QUAJTURA: "RREGULLAT E PËRDORIMIT PËR BLACKBERRY SOLUTION TUAJ" (SEKSIONI 3), " LIÇENSA E PROGRAMIT DHE DOKUMENTACIONIT" (SEKSIONI 2), "PRONËSIA INTELLEKTUALE" (SEKSIONI 11), "KUFIZIMET E IMPORTIT, EKSPORTIT DHE PËRDORIMIT DHE LIÇENSAT E QEVERISË TË SH.B.A-SË" (SEKSIONI 12), "KONFIDENCIALITETI DHE ASNJË NDRYSHIM INXHINIERIK" (SEKSIONI 15); DHE "TË DHËNAT E PËRDORUESIT"

(SEKSIONI 25, DHE (iv) ZBATOHEN NË TOTAL, TEK RIM APO GRUPI I SHOQËRIVE TË RIM, PASARDHËSIT E TYRE, PËRFITUESIT, DHE SHPËRNDARËSIT E AUTORIZUAR TË RIM (DUKE PËRFSHIRË OFRUESIT E SHËRBIMIT AIRTIME QË VEPROJNË SI SHPËRNDARËS TË AUTORIZUAR TË RIM TË PROGRAMIT).

- (g) NË ASNJË RAST NDONJË NËNPUNËS, DREJTOR, PUNONJËS, AGJENT, SHPËRNDARËS, OFRUES (PËRVEC NJË SHITËSI OFERTE), OFRUES SHËRBIMI, KONTRAKTUES I PAVARUR, OSE ÇDO OFRUES I SHËRBIMIT AIRTIME (PËRVEC SIÇ PËRCAKTOHET MË SIPËR) I SHOQËRIVE TË GRUPIT TË RIM NUK KANË NDONJË PËRGJEGJËSI QË RRJEDH NGA OSE NË LIDHJE ME KËTË MARRËVESHJE.
- (h) JU PRANONI DHE BINI DAKORT QË REFUZIMET, PËRJASHTIMET DHE KUFIZIMET E PËRCAKTUARA NË KËTË MARRËVESHJE PËRBËJNË NJË ELEMENT THELBËSOR TË MARRËVESHJES MIDIS PALËVE DHE SE NË MUNGESË TË KËTYRE REFUZIMEVE, PËRJASHTIMEVE DHE KUFIZIMEVE: (i) TARIFAT DHE KUSHTET E TJERA NË KËTË MARRËVESHJE DO TË JENË THELBËSISHT TË NDRYSHME, DHE ( ii) AFTËSIA E RIM PËR TË OFRUAR DHE AFTËSIA JUAJ PËR TË PËRFITUAR LIÇENSËN E PROGRAMIT SIPAS KËSAJ MARRËVESHJE DHE/OSE AFTËSIA E RIM PËR TË BËRË ARTIKUJT E PALËS SË TRETË DHE SHËRBIMET E PALËS SË TRETË TË ARRITSHME NËPËRMJET BLACKBERRY SOLUTION TUAJ DO TË KETË NDIKIM.

ASGJË NË KETË MARRËVESHJE NUK KA SI QËLLIM TË ZEVENDËSOJE NDONJË MARRËVESHJE TË SHKRUAR OSE GARANCI TË SIGURUAR NGA RIM PËR PJESËT E BLACKBERRY SOLUTION TUAJ PËRVEC PROGRAMIT DHE SHËRBIMEVE TË RIM.

24. Miratimi i Mbledhjes së Informacionit, Përdorimit, Transferimit, Ruajtjes dhe Zbulimit (së bashku, “Përpunim”) i Informacionit.

Informacioni personal që Përpunohet nga Shoqëritë e Grupit të RIM dhe ofruesit e shërbimeve të tij do të trajtohet në përputhje me Politikën e Privacisë së RIM (e cila është bërë pjesë e kësaj marrëveshje me referencë dhe mund të shihet në [www.BlackBerry.com/legal](http://www.BlackBerry.com/legal) ose merret duke dërguar email tek [legalinfo@rim.com](mailto:legalinfo@rim.com)). Aty ku është e zbatueshme, kontrolluesi i të dhënave në lidhje me të dhënat Tuaja personale është personi juridik RIM me të cilin ju keni lidhur këtë marrëveshje; duke patur parasysh që, në lidhje me të dhënat Tuaja personale të mbledhura në lidhje me shpërndarjen e Ofertave ndërmjet Magazinës RIME, kontrolluesi i të dhënave është personi juridik RIME i zbatueshëm me të cilin ju keni lidhur një marrëveshje që rregullon atë shpërndarje.

- (a) Informacioni Personal. Instalimi dhe/ose Përdorimi Juaj i BlackBerry Solution Tuaj (apo ndonjë pjesë të tij) Shërbimet e RIM ose i Shërbimit Airtime të lidhur mund të çojë në Përpunimin e informacionit personal siç përcaktohet nga ligji i zbatueshëm rreth Jush dhe Përdoruesve Tuaj të Autorizuar (së bashku, “Përdoruesi”) nga Shoqëritë e Grupit RIM dhe ofruesit e shërbimit të tij, Ofruesit Tuaj të Shërbimit Airtime, dhe palëve të treta me produktet ose shërbimet të përdorura me BlackBerry Solution Tuaj. Në varsi të shërbimeve të përdorura, informacion personal mund të përfshijë informacione të tilla si emër, adresë e-maili, numër telefoni, ID e BlackBerry, kredencialet dhe rregullimet e llogarisë, informacione të Produktit Handheld (p.sh. PIN e Produktit Handheld ose identifikuesit e tjerë të pajisjes), informacion mbi vendndodhjen e Produktit Handheld (siç përshkruhet më poshtë), informacionit për Ofruesin e Shërbimit Airtime, dhe informacionit në lidhje me përdorimin e funksionalitetin e BlackBerry Solution Tuaj dhe

Shërbimeve të RIM ose të hardware-it dhe programit të përdorur së bashku me BlackBerry Solution Tuaj). Ju jepni pëlqimin që Shoqëritë e Grupit të RIM mund të mbledhin këto informacione personale nga Ju direkt, ose ti marrin ato nga Ofruesit e Shërbimit Airtime ose palët e treta me produktet ose shërbimet e përdorura me BlackBerry Solution Tuaj.

- (b) Qëllimet. Në përputhje me Politikën e Privacisë së RIM, informacioni personal mund të Përpunohet nga Shoqëritë e Grupit të RIM dhe ofruesit e shërbimit të tij për qëllimet e lidhura me (i) kuptimin dhe artijen e nevojave dhe preferencave Tuaja dhe t'ju pajisjn Ju me BlackBerry Solution Tuaj; (ii) zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të reja dhe zgjerimin e atyre ekzistuese, duke përfshirë komunikimin me JU rreth tyre; (iii) menaxhimi dhe zhvillimi i biznesit dhe punës së Shoqërive të Grupit të RIM; dhe (iv) arritjen e kërkesave ligjore dhe rregullatore. Për më tepër, RIM mund të mundësojë ose të dërgojë tek Përdoruesit përmirësime dhe azhurnime, ose njoftime të përmirësimeve dhe azhurnimeve të Programit, ose produkteve dhe shërbimeve të tjera të RIM, Programit të Palës së Tretë, Përmbajtjes së Palës së Tretë, Shërbimet e Palës së Tretë dhe produktet ose shërbimet përkatëse.
- (c) Shërbimet "Cloud-based". Nëse Ju regjistrohëni në ose përdorni mesazhet ose shërbimet "cloud based", ose përdorni akses, ruajtje ose mbështetje funksionale në distancë të ofruar nga SHOQËRITË E GRUPIT RIM ose ofruesit e shërbimit të tyre, informacioni që Ju fusni, parqisni tek , ose integroni me këto shërbime (p.sh., shfaqja e emrave dhe fotove, mesazheve të statusit, infomracione të listës ose grupeve të kontakteve, kalendarit, ose informacione të tjera në-pajisje të tilla si detyrat dhe skedarët e medias) mund të Përpunohen nga SHOQËRITË E GRUPIT të RIM për të mundësuar shërbimet e ofruara në përputhje me marrëveshjen(t) Tuaj me RIM, dhe Ju deklaroni dhe garantoni se Ju keni të gjithë pëlqimet e nevojshme për t'ia dhënë këto të dhëna tek RIM. Nëse BlackBerry AppEorld dhe My Eorld ose çdo shërbim i ngjashëm përdoret, atëherë Shoqëritë e Grupit të RIM mund të Përpunojnë informacionin rreth së cilit, Programi, Shërbimet RIM, Artikujt e Palës së Tretë dhe/ose Shërbimet e Palës së Tretë shkarkohen dhe përdoren nga Produkti Juaj Handheld.
- (d) Funksionaliteti Social. Shërbime të caktuar të RIM ose karakteristika të Programit mund të përfshijnë funksionalitet "social" që ju lejon Juve të bëni Veteveten të zbulueshëm dhe të lidheni me individë të tjerë, dhe të përmirësoni ose zgjeroni eksperienceën Tuaj me Shërbimet apo Programin e RIM, ose Programin e Palës së Tretë ose Shërbimet e Palës së Tretë që janë të integruar me funksionalitetin social që ju është mundësuar nga RIM. Nëse Ju e përdorni këtë funksionalitet, Ju bini dakort që disponibiliteti Juaj për të ndërvepruar ose lidhur me të tjerët mund të indikohet te të tjerët, dhe profili juaj, emrat e shfaqur, fotografitë e shfaqura, mesazhet e stautsit, statusi i anëtarësisë, dhe identifikues ose informacione të tjera mund të shikohen dhe komentohen nga këta individë. Për shembull, nëse Ju përdorni një Shërbim të RIM ose Shërbim të Palës së Tretë që është i integruar me " Platformën Sociale BlackBerry Messenger " të RIM, Ju bini dakort se: (i) kontaktet e BlackBerry Messenger Tuaj mund të shohin nëse Ju jeni duke përdorur këtë Shërbim të RIM ose Shërbim të Palës së Tretë, (ii) kontaktet e BlackBerry Messenger Tuaj mund të shohin profiling Tuaj dhe programin dhe Përmbajtjen (të tilla si lojrat, muzikën ose skedarë të tjerë të medias, në varësi të Shërbimit të RIM ose Programit të Palës së Tretë) që Ju keni shkruar, jeni duke konsumuar, ose që është i disponueshëm për ndarë si pjesë e përdorimit Tuaj të Shërbimit të RIM ose Shërbimit të Palës së Tretë, si dhe komentet që Ju ose të tjerët bëni rreth tyre, (iii) që kur ju jepni komente rreth kontakteve Tuaja ose programit ose Përmbajtjes që ata kanë shkarkuar ose janë duke konsumuar si pjesë e përdorimit të tyre të Shërbimit të RIM ose Shërbimit të Palës së Tretë, informacione rreth Jush (të tilla si komentet Tuaja, emri i profilit të përdoruesit, dhe fotografiteë e shfaqura) mund të shfaqen tk kontakte të tjerë të atij individit, dhe (iv) Shërbimi i RIM ose Shërbimi i Palës së Tretë mund të përfshijë funksionalitetin automaitk që kryen analiza për të zhvilluar rekomandime bazuar në preferencat dhe përdorimin Tuaj të Shërbimit ose Programit të RIM. Jeni të lutur te kontrolloni opsionet e rregullimeve të zbatueshme për Shërbimin



ose Programin e RIM të zbatueshëm për opsione të disponueshme që rregullojnë disponibilitetin ose rregullimet e privacisë për këto Shërbime ose Program të RIM.

- (e) Integrimi me Shërbimet e Palës së Tretë. Nëse Ju zgjidhni të integroni ose lidhni BlackBerry Solution Tuaj me Shërbimet e Palës së Tretë (për shembull, shërbimet e emailit të palës së tretë, ose shërbime që mundësojnë përdorimin Tuaj të Produktit(eve) Tuaj(a) për të hyrë dhe përdorur rrjetet sociale ose shërbime të tjera të ofruara nga palët e treta), Ju autorizoni RIM të përdorë kredencialet Tuaja për të hyrë tek Shërbimet e Palës së Tretë në emrin Tuaj dhe të Përpunojë informacionin Tuaj personal që lidhet me këto Shërbime të Palës së Tretë për të mundësuar hyrjen Tuaj tek këto Shërbime të Palës së Tretë për qëllimet Tuaja personale dhe/ose të brendshme. Informacioni i Përpunuar mund të përfshijë: (i) Identitetin Tuaj të përdoruesit, fjalëkalimin, shënjat e autentifikimit ose kredenciale të tjera për çdo shërbim emaili të palës së tretë ose llogari të tjera të cilat Ju i integroni me BlackBerry Solution Tuaj; (ii) informacionin Tuaj të profilit të llogarisë të Programit (për shembull, Identitetin e BlackBerry, fotografine Tuaj të shfaqur, emrin e shfaqur, mesazhin personal, statusin e disponueshmërisë, vendin, zonën orare, identifikuesit unike të pajisjes, etj.); (iii) informacionet e kontakteve në pajisje, (iv) një indikim se me kë aplikacion ose shërbime të palës së tretë Ju keni lidhur me llogarinë e Programit Tuaj; dhe (iii) sesioni i të dhënave që rezultojn nga përdorimi Juaj i aplikacioneve ose shërbimeve të palës së tretë që Ju keni lidhur me llogarinë e Programit Tuaj (për shembull, rezultatet më të larta që Ju keni arritur në një lojë ose aplikacion të lidhur të palës së tretë për tu shfaqur në kutinë e profilit të llogarisë të Programit Tuaj, të dhënat e mesazheve të momentit që rezultojn nga bisedat me mesazhe të momentit që Ju keni bërë brenda një aplikacioni apo shërbimi të lidhur të palës së tretë dhe është mundësuar nga funksionaliteti i Programit të dërgimit të mesazheve të momentit, etj.). Ju gjithashtu autorizoni RIM të zbulojë këto informacione tek ofruesit e Shërbimeve të Palës së Tretë të zbatueshëm për qëllime aktivizimi, faturimi, ofrimi, mirëmbajtje dhe caktivizimi. Nëse Ju përdorni Shërbimet e Palës së Tretë dhe Programin e Palës së Tretë për të lidhur me Produktin Tuaj BlackBerry Handheld, palët e treta mund të kenë mundësinë të lexojnë, hyjnë, eksportojnë dhe në çdo mënyrë të Përpunojnë të dhënat (duke përfshirë informacionin personal) të ruajtur në Produktin Tuaj BlackBerry Handheld. Këto shërbime të palës së tretë që janë aksesuar nuk janë nën kontrollin e RIM. Nëse informacioni Juaj personal zbulohet Ofruesi Juaj i Shërbimit Airtime, ose palë të treta me produkte ose shërbimet e përdorura me BlackBerry Solution Tuaj, përdorimi Juaj do të nënshtrohet marrëveshjes(ve) të zbatueshme dhe politikave të privacisë të këtyre palëve të treta, dhe Ju duhet të rishikoni këto kushte përpara përdorimit të Shërbimeve të Palës së Tretë dhe Programit të Palës së Tretë. Ju duhet të rishikoni opsionet ose menunë e ndihmës të Produktit Tuaj Handheld me qëllim për të mësuar më shumë rreth tyre, dhe aty ku është e zbatueshme, rregulloni lejet e dhëna dhe kontrollat e disponueshme për këto Shërbime të Palës së Tretë dhe Programin e Palës së Tretë.
- (f) Cookies dhe Teknologji të e ngjashme. Shoqëritë e Grupit të RIM mund të përdorin "cookies" (pjesë të vogla të dhënash të ruajtura në kompjuterin tuaj ose në Pajisjen Handheld) ose mjete të ngjashme duke përdorur informacion anonim për t'ju mundësuar Juve të lidheni me disa shërbime për të mbrojtur si Ju dhe RIM, ndihmuar të bëni Shërbimet e RIM më të lehta për tu përdorur ose të matur eksperiencën Tuaj, ose për analitikët për të na ndihmuar ne të kuptojmë se si përdoruesit punojnë me Shërbimet tona të RIM dhe BlackBerry Solution dhe të përmirësojnë karakteristikat e tyre. Jeni të lutur të kontrolloni rregullimet në shfletuesin e Produktit Tuaj Handheld në lidhje me mënyrën se si të heqni ose bllokoni cookies të shfletuesit.
- (g) Garantimi i Mbështetjes dhe Cilësisë. Nëse Ju kontaktoni RIM për mbështetje ose riparim të Produktit Tuaj Handheld, ose dërgoni informacione diagnostikuese ose informacione të tjera teknike të RIM ndërmjet email ose mjetet e regjistrimit të ofruara nga RIM për këto qëllime, Ju bini dakort që Shoqëritë e Grupit të RIM mund të mbledhin informacione teknik si numrin PIN të

Produktit Handheld, Identifikimin e hardware-it dhe numrin e modelit, statusin e memories, sistemin e operimit dhe informacione të mjedisit, gjendjen e baterisë, Ëi-Fi, fuqia dhe lidhjet radio ose pa kabëll (ëireless), listën e aplikacioneve të instaluara, informacionin e përdorimit të aplikacionit apo programit, të dhëna në lidhje me proceset që janë duke punuar dhe konfigurimin e pajisjes, ngjarjet e sistemit, dhe informacione të tjera në lidhje me gjendjen e produktit tuaj BlackBerry që mund të jetë i dobishëm për qëllime diagnostikimi. Ky informacion do të përdoret për qëllime të zgjidhjes së problemeve, suportit të klientit, azhurnimeve të programit, dhe përmirësimeve të produkteve dhe shërbimeve të RIM në përputhje me Politikën e Privacisë së RIM. Nëse analiza tregon se është përfshirë një produkt i palës së tretë, RIM mund të dërgojë këto informacione diagnostikuese ose teknike tek shitësi i palës së tretë të produktit si pjesë e procesit të zgjidhjes së problemit. Ju pranoni dhe bini dakort që thirrjet me RIM dhe ofruesit e tij të shërbimit mund të regjistrohen për qëllime trainimi, sigurimi të cilësisë, shërbimit me klientin dhe reference.

- (h) Të Dhëna mbi Vendndodhjen. Shoqëritë e Grupit të RIM mund të ofrojnë disa karakteristika ose shërbime që bazohen mbi informacionin e vendndodhjes duke përdorur GPS ose shërbime të ngjashme satelitore (aty ku është e mundur) ose pikat e aksesit Wi-Fi croëd-sourced dhe vendndodhjet e kullave celulare. Për shembull, aty ku është e mundur karakteristika të caktuara të Programit ose BlackBerry Solution mund t'ju lejojnë Ju të ndani vendndodhjen Tuaj me kontaktin(et) tuaja, ose të lokalizoni, dërgoni një mesazh, të luani një tingull, ose të bllokoni ose fshini në largësi Produktin Tuaj Handheld (duke iu nënshtruar mbulimit të Ofruesit të Shërbimit Airtime, kushtet e Produktit Tuaj Handheld, dhe burimet e sistemit në kohën e kërkesës). Karakteristika ose produkte të tjera të BlackBerry Solution mund gjithashtu të mbledhin informacion anonim direktional dhe të drejtpërdrejtë (p.sh. Trafikun BlackBerry) ose pyetje të kërimit të vendndodhjes për të mundësuar ose përmirësuar Shërbimet e RIM që Ju përdorni. Për të ofruar këto karakteristika ose shërbime, informacioni mbi vendndodhjen e Produktit Handheld (duke përfshirë informacionin GPS, ID e ofruesit të shërbimit, ID e kullës, Identifikuesi i Setit të Shërbimit Bazë ("BSSID ") të pikës së aksesit Wi-Fi, dhe fuqinë e sinjalit të pikave të aksesit të Ëi-Fi dukshme ose kullave celulare) mund ti komunikohen Shoqërive të Grupit të RIM kur Ju përdorni Produktin Tuaj Handheld ose mundësoni shërbimet e të dhënave dhe funksionalitetet e bazuar në vendndodhje. Shoqëritë e Grupit të RIM nuk e mbajnë këtë informacion në një formë që personalisht identifikon një përdorues, dhe mund ta përdorë këtë informacion për tu mundësuar Juve me dhe përmirësojë shërbimet e bazuara te vendndodhja të ofruara nga ose në emër të Shoqërive të Grupit të RIM ose atyre të ofruara nga Shërbimet e Palëve të Treta të përdorura me BlackBerry Solution Tuaj. Shoqëritë e Grupit RIM mund gjithashtu të përdorin këtë informacion për të krijuar të dhëna të cilat janë grumbulluar ose janë bërë anonime për të ofruar reklama të bazuara në informacion dhe të ndikuar nga vendndodhja. Jeni te lutur te rishikoni opsionet ose menunë e ndihmës të Programit BlackBerry Handheld në lidhje me se si të zgjidhni fikni ose të rregulloni karakteristikat e vendndodhjes në pajisje, ose të instaloni nga Produkti Juaj Handheld aplikacionet që mund të përdorin informacionin e vendndodhjes. Kur përdorni Shërbimet e Palës së Tretë që përdorin ose ofrojnë të dhëna mbi vendndodhjen, Ju i nënshtroheni dhe duhet të rishikoni kushtet dhe politikat e privacisë së palës së tretë mbi përdorimin e të dhënave të vendndodhjes nga këto Shërbime të Palës së Tretë, dhe Ju duhet ti jepni konsideratën e duhur para se të bini dakort për zbulimin e informacionit të vendndodhjes Tuaj tek persona të tjerë.
- (i) Transfertat Ndërkombëtare. Ju pranoni dhe bini dakort se për të ofruar BlackBerry Solution dhe Shërbimet RIM (duke përfshirë "cloud based" dhe aksesin në distancë, funksionalitetin e ruajtjes ose të back-up), Shoqëritë e Grupit RIM mund të Përpunojnë të dhëna, të cilat në shumë raste përfshijnë informacion personal dhe përmbatja e komunikimeve, në serverat e operuar nga ose në emër të Shoqërive të Grupit të RIM brenda ose jashtë juridiksionit në të cilin Përdoruesit kanë vendndodhjen, duke përfshirë, në Kanada, Shtete e Bashkuara të Amerikës, Mbretërinë e Bashkuar, Singapor ose vende të tjera ku ka pajisje që operohen nga ose në emër të Shoqërive të

Grupit të RIM. Nëse Përdoruesit janë resident të Zonës Ekonomike Europiane ose të ndonjë juridiksioni për të cilin kërkohet pëlqimi për të transferuar informacionin personal jashtë atij juridiksionit ose rajoni, Ju jepni pëlqimin për këtë Përpunim dhe garantoni se Ju keni marrë të gjithë pëlqimet e nevojshme sipas ligjit të zbatueshëm nga Përdoruesit Tuaj për këtë qëllim.

25. Të dhënat e Përdoruesit. Në vijim të çdo zbulimi të autorizuar nga Seksioni 24, Ju dhe Përdoruesit Tuaj të Autorizuar jepni pëlqimin dhe jeni dakort se Shoqëritë e Grupit RIM mund të aksesojnë, ruajjnë, dhe zbulojnë të dhënat Tuaja ose të Përdoruesve Tuaj të Autorizuar, duke përfshirë informacionin personal, përmbajtjen e komunikimeve tuaja ose informacionin rreth përdorimit të BlackBerry Solution Tuaj funksionalitetit dhe shërbimeve ose programit dhe hardware-it të përdorur së bashku me BlackBerry Solution Tuaj kur i është bërë e mundur RIM ("Të dhënat e Përdoruesit"), palëve të treta, duke përfshirë entete qeveritare të huaja ose të brendshme, pa ju dhënë njoftim Juve ose Përdoruesve Tuaj të Autorizuar sipas ligjeve të vendeve ku ndodhen Shoqëritë e Grupit të RIM dhe ofruesit e tij të shërbimit, partner të tjerë dhe filialet me qëllim që: (i) të përputhen me proceset ligjore ose kërkesat qeveritare të zbatueshme, ose siç mund të kërkohet nga ligji; (ii) të bashkëpunojë me palë të treta në hetimin e veprimeve në shkelje të kësaj Marrëveshje; ose (iii) të bashkëpunojë me administratorët e sistemeve të ofruesve të shërbimit të Internetit, rrjetet ose pajisjet kompjuterike me qëllim që të zbatojë këtë Marrëveshje. Ju garantoni se Ju keni marrë të gjithë pëlqimet e nevojshme sipas ligjit të zbatueshëm nga Përdoruesit Tuaj të Autorizuar për të zbuluar Të dhënat e Përdoruesit tek Shoqëritë e Grupit të RIM dhe për Shoqëritë e Grupit të RIM të mbledhë, përdorë, përpunojë, transmetojë dhe/ose zbulojë këto Të dhëna të Përdoruesit siç përshkruhet më sipër.

26. Transferimi dhe Delegimi. RIM mund të transferojë këtë marrëveshje pa Ju njoftuar. Ju nuk do ta transferoni këtë Marrëveshje në tëresi ose në pjesë pa miratimin paraprak me shkrim të RIM (ky miratim mund të mbahet ose të kushtëzohet sipas gjykimit të RIM) dhe çdo transferim pa miratimin paraprak me shkrim të RIM do të jetë i pavlefshëm dhe do të anulohet dhe nuk do të ketë efekt. RIM mund të përmbush të gjitha detyrimet sipas kësaj Marrëveshje në mënyrë të drejtpërdrejtë ose mund të ketë disa ose të gjitha detyrimet e përmbushura nga kontraktuesit ose nënkontraktuesit e tij.

27. Njoftime. Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në Marrëveshje, të gjitha njoftimet ose komunikimet e tjera sipas kësaj Marrëveshje do të konsiderohen të dhëna sipas mënyrës së duhur nëse ato janë bërë me shkrim dhe dorëzuar personalisht, me korrier ose depozituar në postë, me tarifë postare të parapaguar, me postë rekomande ose ekuivalentin e tij, lajmërim marrje i kërkuar, dhe adresuar Juve në adresën e faturimit që Ju i keni dhënë RIM, dhe i adresuar tek Research In Motion UK Limited, 200 Bath Road, Slough, Berkshire, United Kingdom SL1 3XE, Në vëmendje të Drejtorit të Përgjithshëm; në rastin e RIME në adresën e listuar në <http://www.BlackBerry.com/legal/rime>; dhe në secilin rast me një kopje (e cila nuk përbën njoftim) te Drejtori i Departamentit Juridik i RIM në adresën 295 Philip Street, Waterloo, Ontario, Canada N2L 3W8. Përveç sa me sipër, RIM mund të zgjedh që, t'ju japi ndonjë njoftim elektronikisht sipas kësaj Marrëveshje. Njoftimi elektronik do të konsiderohet i dhënë në mënyrën e duhur nëse transmetohet në adresën e e-mailit të dhënë RIM nga Ju dhe nëse Ju nuk i keni dhënë RIM këtë adresë, njoftimi mund të konsiderohet i dhënë rregullisht kur do të postohet dukshëm në <http://www.BlackBerry.com/legal/>.

28. Forca madhore. Pavarësisht çdo dispozitë tjetër të kësaj Marrëveshje, asnjë nga Palët nuk do të konsiderohet në dështim të kësaj Marrëveshjeje për mospërmbushje të detyrimeve të saja për shkak të arsyeve që kalojnë përtëj kontrollit të arsyeshëm. Kjo dispozitë nuk do të interpretohet si moskryerje e justifikuar e çdo detyrimi nga secila Palë për të kryer pagesën Palës tjetër sipas kësaj Marrëveshjeje.

29. Të përgjithshme

- (a) Përfituesit e Palës së Tretë. Filialet e RIM dhe RIM dhe drejtorët e filialeve të saj, oficerët dhe punonjësit e tyre nënkuptohen të jenë përfituesit e palës së tretë për qëllimin e Seksioneve të

kësaj Marrëveshjeje të quajtura, " Informacione për Sigurinë në lidhje me Përdorimin e Teknologjisë " (Section 8(b)), "Dëmshtëpërblimi/Përgjegjësitë" (Seksioni 19), "Kufizimi i Përgjegjësisë" (Seksioni 23) dhe "Refuzimet" (Seksioni 22). Ofruesit e Përmbajtjes për Shërbimet e RIM janë përfitues të palës së tretë të mbrotjeve dhe kufizimeve mbi përdorimin e Përmbajtjes së tyre të përcaktuar në "Rregullat e Përdorimit të BlackBerry Solution" (Seksioni 3) dhe "Pronësia Intelektuale " (Seksioni 11). Përveç siç shprehet ndryshe në mënyrë specifike në këtë Seksion, dispozitat e këtijSeksioni janë në dobi të Palëve dhe jo për ndonjë person apo ent tjetër.

- (b) Heqja dorë nga Mospërmbushja. Asnjë Palë nuk do të konsiderohet të ketë hequr dorë ose humbur ndonjë të drejtë sipas kësaj Marrëveshjeje, qoftë në bazë të mospërmbushjes së detyrimeve, vonesës apo të ndonjë të drejte ose doktrine tjetër ligjore, përveç në se heqja dorë është bërë me shkrim dhe nënshkruar nga një nënshkruar i autorizuar i Palës kundrejt së cilës heqja dorë kërkohet të zbatohet. Heqja dorë nga ndonjë dispozitë, ose shkëlja e ndonjë dispozitë, të kësaj Marrëveshjeje në një instancë nuk do të thotë heqje dore për sa i përket ndonjë instance tjetër.
- (c) Lënia në fuqi. Afatet, kushtet dhe garancitë e përfshira në këtë Marrëveshje që sipas kuptimit apo kontekstit kanë për qëllim ti mbijetojnë ekzekutimit të saj do ti mbijetojnë dhe përmbushjes së ekzekutimit, anulimit dhe zgjidhjes së Marrëveshjes, duke përfshirë, seksionet e dëmshtëpërblimit.
- (d) Ligji dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve. Kjo Marrëveshje do të rregullohet nga dhe interpretohet sipas ligjeve të Anglisë dhe Uellsit duke përjashtuar cilin do organizëm të së drejtës që rregullon konfliktet ligjore. Palët bien dakort që Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Kontratat për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave përjashtohet në tërësi nga aplikimi të kësaj Marrëveshjeje. Çdo mosmarrëveshje ose diskutim që rrjedh ose në lidhje me këtë Marrëveshje, apo shkëlje të tyre, të cilat Palët nuk janë në gjendje ta zgjidhin pas negociatave në mirëbesim, duhet ti dërgohet fillimisht nivelit më të lartë të menaxhimit të Palëve. Palët, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të nivelit më të lartë të menaxhimit, të cilat nëse jeni një individ, jeni Ju, do të takohen brenda tridhjetë (30) ditësh nga datë që mosmarrëveshja u është drejtuar atyre dhe në qoftë se Palët nuk janë në gjendje për të zgjidhur këto mosmarrëveshje ose diskutime brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e takimit, përveç për aq sa ndalohej specifikisht nga ligji i zbatueshëm në juridiksionin Tuaj, mosmarrëveshje ose diskutime të tilla do të zgjidhen nga arbitrazhi përfundimtar dhe detyruar që do të zhvillohet në Londër, Angli në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë ("Rregullat e ICC") dhe do të dëgjohet nga një arbitër i emëruar në përputhje me Rregullat e thëna të ICC dhe do të bihet reciprokisht dakord nga Palët brenda tridhjetë (30) ditëve nga emërimi i arbitrit, ku dështimi në caktimin e arbitrit, ky i fundit do të emërohet nga Kryetari i Shoqatës Britanike Kompjuterike (ose nga një person i emëruar nga Presidenti për të vepruar në emrin e tij ose të saj) mbi zbatimin e secilës nga Palët për kohën që është në fuqi, të rregullave të cilat konsiderohen të jenë inkorporuar me referencë në këtë kapitull. Nëse dispozitat e mësipërme janë të ndaluara me ligj në juridiksioninTuaj, arbitrazhi do të: (i) mbahet në juridiksionin Tuaj; (ii) vendoset me arbitrazh në përputhje me rregullat e arbitrazhit dhe Proçedurat e Qëndrës MEDART ("Rregullat e MEDART"); dhe (iii) dëgjohet nga një arbitër i emëruar në përputhje me Rregullat e MEDART dhe të bihet reciprokisht dakort nga Palët brenda tridhjetë (30) ditëve nga emërimi i arbitrit, në mungesë të së cilit, një palë neutrale emëron arbitrin. Secila Palë do të paguaj gjysmën e shpenzimeve lidhur me proçedurat e arbitrazhit. Asnjë mosmarrëveshje midis Palëve, ose që përfshin ndonjë person përveç Jush, nuk mund të bashkohet apo të kombinohet së bashku, pa pëlqimin paraprak me shkrim të RIM. Vendimi i dhënë nga ana e arbitrit mund të ankimohet në çdo Gjykatë që ka juridiksion. Pavarësisht nga e

mësipërmja, RIM ka të drejtë që të ndërmarrë proçedura ligjore ose të barabarta, duke përfshirë edhe proçedura që kërkojnë marrjen e masave të sigurisë, në një gjykatë për pretendime apo mosmarrëveshje lidhur me: (i) shumat që Ju i detyroheni RIM në lidhje me blerjen Tuaj të BlackBerry Solution Tuaj ose ndonjë pjesë të saj, nëse zbatohet, dhe (ii) për shkeljen Tuaj apo kërcënimin për shkelje të Seksioneve të Marrëveshjes të quajtura, "Rregullat e Përdorimit të BlackBerry Solution Tuaj " (Seksioni 3), "Liçensa e Programit dhe Dokumentacionit" (Seksioni 2), "Prona Intelektuale" (Seksioni 12), "Kufizimet e Eksportit, Importit dhe Përdorimit dhe Liçensat e Qeverisë të SH.B.A". (Seksioni 12), "Siguria" (Seksioni 12), "Konfidencialiteti dhe Asnjë Ndryshim Inxhinierik" (Seksioni 15) dhe "Pasojat e Zgjidhjes" (Seksioni 18). Ju hiqni dorë në mënyrë të përvokueshme nga ndonjë vërejtje lidhur me vendin e gjykimit, forumit jo-të përshtatshëm apo për ndonjë arsye të ngjashme dhe jepni pëlqimin e përvokueshëm për shërbimin e proçesit me postë ose në ndonjë mënyrë tjetër të lejuar nga ligji në fuqi dhe jepni pëlqimin e përvokueshëm, nënshtroheni dhe pranoni juridiksionin e gjykatave të ndodhura në Angli për çdo pretendim të tillë që del nga apo në lidhje me këtë Marrëveshje. Palët pajtohen në mënyrë specifike që, në rast se ka ndonjë mosmarrëveshje me këtë Marrëveshje dhe këto mosmarrëveshje do të zgjidhen në një gjykatë, mosmarrëveshje të tilla nuk do të zgjidhen nga gjykimi me juri. Palët heqin dorë këtu nga të gjitha të drejtat për gjykim të jurisë të çdo çështjeje në lidhje me ose që rrjedh nga kjo Marrëveshje.

- (e) Veçueshmëria. Për aq sa çdo seksion, klauzolë, dispozitë apo fjali apo pjesë ("Pjesë") e kësaj Marrëveshjeje vendoset që është e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme nga një autoritet kompetent në ndonjë juridiksion, atëherë ky vendim i kësaj Pjesë nuk do të ndikojë në: (i) ligjshmërinë, vlefshmërinë apo zbatueshmërinë e Pjesëve të mbetura të kësaj Marrëveshjeje; ose (ii) ligjshmërinë, vlefshmërinë apo zbatueshmërinë e kësaj Pjesë në ndonjë juridiksion tjetër, dhe kjo Pjesë do të jetë e kufizuar nëse është e mundur dhe vetëm më pas e vecuar, nëse është e nevojshme, për aq sa kërkohej që ta bëjë Marrëveshjen të vlefshme dhe të zbatueshme.
- (f) Gjuha. Nëse kjo Marrëveshje është përkthyer në një gjuhë tjetër veç Anglishtes, versioni Anglisht do të ketë përparësi në rastet kur do të ketë ndonjë konflikt ose mospërputhje në përmbajtje ndërmjet versionit Anglisht dhe çdo lloj përkthimi tjetër. Përveç, dhe vetëm për aq sa, ndalohet me ligj nga juridiksioni Juaj, çdo ose të gjitha mosmarrëveshjet, konfliktet, ndërmjetësimet, arbitrazhet apo çështjet gjyqësore në lidhje me këtë Marrëveshje do të drejtohen në gjuhën Angleze duke përfshirë, pa u kufizuar, çdo lloj korrespondence, zbulimi, paraqitje, depozitim, konkluzione, mbrojtje verbale, diskutime, diskutime verbale dhe urdhëra ose vendime.
- (g) Mospërputhja. Në qoftë se ka ndonjë mospërputhje ndërmjet kësaj Marrëveshjeje dhe çfarëdo liçense programi ose marrëveshjeje të përdoruesit fundor (të ndryshme nga kjo Marrëveshjeje) të dhënë në materialet pakuese ose shoqëruese të çfarëdo pjesë të BlackBerry Solution Tuaj, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të zbatohen për aq sa është mospërputhja. Në qoftë se ka ndonjë mospërputhje ndërmjet kësaj Marrëveshjeje dhe çfarëdo liçense programi ose marrëveshjeje të përdoruesit fundor në lidhje me çfarëdo azhurnimi ose përmirësimi të Programit, dispozitat e një marrëveshjeje tjetër të tillë ose marrëveshjeje me përdoruesin fundor do të zbatohet për aq sa është mospërputhja. Në rastin e çfarëdo mospërputhjeje ndërmjet çdo dokumentacioni të dhënë në paketim të çdo pjesë të BlackBerry Solution Tuaj dhe Dokumentacionit për Produktin e përshtatshëm të RIM ose artikull të Programit, dispozitat e Dokumentacionit do të zbatohen për aq sa është mospërputhja.
- (h) Tërësia e Marrëveshjes. Kjo marrëveshje (e cila për qëllim të çdo Shtese këtu, do të përfshijë në lidhje me objektin e Shtesës, kushtet e kesaj Shtese), përbën marrëveshjen në tërësi të

Palëve në lidhje me objektin këtu dhe nuk ka dispozita, mirëkuptime, komunikime, deklarime, garanci, ndërmarrje, marrëveshje kolaterale ose marrëveshje midis Palëve lidhur me Programin përveç asaj të përmendur në këtë Marrëveshje. Pavarësisht sa më sipër, marrëveshje të tjera midis Palëve mund të rregullojnë përdorimin e pjesëve të tjera të BlackBerry Solution Tuaj. Kjo Marrëveshje shfuqizon çfarëdo dispozite të mëparshme ose bashkëkohore, mirëkuptime, komunikime, deklarime, garanci, premtime, marrëveshje kolaterale ose marrëveshje midis Palëve, qofshin ato verbale ose me shkrim, në lidhje me këtë objekt dhe Ju pranoni që nuk mbështeteni në asnjë nga të sipërpërmendurat duke pranuar të lidhni këtë Marrëveshje. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet në çdo kohë me marrëveshje të përbashkët nga Palët. Përveç rastëve kur RIM është shprehimisht i ndaluar me ligj, RIM rezervon të drejtën ta ndryshojë këtë Marrëveshje mbi një bazë të ardhshme, qoftë për të pasqyruar ndryshimet në të ose të kërkuara nga ligji (duke përfshirë, ndryshime për të siguruar zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshjeje) ose për të ndryshuar praktikatat e biznesit, duke Ju njoftuar paraprakisht mbi ndryshimet qoftë në mënyre elektronike (siç parashikohet nga dispozita Njoftimi me lart) ose duke vendosur lajmërimin e ndryshimit në <http://www.BlackBerry.com/legal> dhe Ju duhet ta shikoni rregullisht faqen e internetit për ndryshime. Nëse Ju vazhdoni të përdorni Programin dhe/ose Shërbime të tjera të RIM për më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë pas dhënies së njoftimit mbi ndryshimin, Ju do të konsideroheni që i keni pranuar këto ndryshime. Nëse keni ndonjë shqetësim në lidhje me ndryshim(et), jeni të lutur të kontaktoni [legalinfo@rim.com](mailto:legalinfo@rim.com) brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve pas dhënies së njoftimit për ndryshim(et) për të kërkuar opsionet Tuaja.

- (i) Përputhshmëria me Ligjet. Ju, me shpenzimet Tuaja, do të merrni dhe mirëmbani të gjitha licencat, regjistrimet dhe miratimet e kërkuara nga autoritetet shtetërore ose ligji përkatës në juridiksionin Tuaj për zbatimin dhe përmbushjen e kësaj Marrëveshje ose ndonjë marrëveshje license të ngjashme. Në veçanti si dhe për të shmangur çdo dyshim, Ju do të zbatoni ligjet dhe rregullat përkatëse në përdorimin dhe instalimin e BlackBerry Solution Tuaj, duke përfshirë sigurimin e çdo license, regjistrimi dhe miratimi të nevojshëm nga autoritetet shtetërore kompetente për importimin dhe përdorimin e çdo Programi që përmban inkriftime tregtare apo funksion tjetër sigurie të kërkuar nga ligji përkatës. Ju do t'i siguroni RIM vërtetimet dhe dokumentat zyrtare që mund të kërkojë periodikisht për të verifikuar përputhshmërinë Tuaj me këtë detyrim. Pa u kufizuar në sa më sipër, duke qënë se disa Shërbime të RIM ose Shërbime të Palës së Tretë mund të aksesohen globalisht, nëse Ju zgjidhni të aksesoni Shërbimet e RIM dhe Shërbimet e Palës së Tretë nga vendndodhje tjetër përveç vendeve për të cilat RIM ose pala e tretë përkatëse tregon ato Shërbime të RIM ose Shërbime të Palës së Tretë janë bërë të mundur, Ju e bëni një gjë të tillë me inisiativën Tuaj dhe Ju jeni përgjegjës për përputhshmërinë me të gjithë ligjet dhe rregulloret përkatëse, duke përfshirë ato në lidhje me eksportin, importin, përdorimin, transmetimin dhe/ose komunikimin e Shërbimeve të RIM, ose Shërbimin e Palës së Tretë të zbatueshëm, dhe Përmbajtja shoqëruese, Artikujt ose Programi i Palës së Tretë. Më tej, RIM nuk bën asnjë deklaram se të gjithë Programet dhe Artikujt e Palës së Tretë të shoqëruar me ose të mundësuar ndërmjet Shërbimit(eve) të RIM (p.sh. nëpërmjet një Magazine RIME dhe ose i blerë duke përdorur Shërbimin e Pagesës BlackBerry) janë të saktë ose të mundur për tu përdorur në të gjithë vendndodhjet, Ju bini dakord se as Ju dhe as Përdoruesit Tuaj të Autorizuar nuk do të shkarkojnë ose të aksesojnë Programin ose Artikujt e Palës së Tretë, ose të tentoni të bëni një gjë të tillë, nga vende ku bërja e kësaj gjëje është e paligjshme. Pa kufizuar sa më sipër, nëse ligji i zbatueshëm ju ndalon Ju ose një Përdorues të Autorizuar të përdorni thirrjet video të tilla si video chat ose funksionalitetin MVS të Programit BlackBerry Handheld, duke përfshirë because peer-to-peer, funksionalitete video ose të bazuar në Internet nuk është e lejuar në juridiksionin Tuaj, sepse Ju ose një Përdorues i Autorizuar jeni nën kufirin e parashkruar të moshës, ose sepse ligjet e lidhura me Shërbimet e Emergjencës, atëherë as Ju dhe as Përdoruesit Tuaj të Autorizuar s'mund të shkarkojnë ose përdorin këto

karakteristika ose produkte të Programit dhe/ose se është përgjegjësia Juan të bëni rregullimet alternative për të aksesuar Shërbimet e Emergjencës.

- (j) Kuptime të Zgjeruara. Ky term "përfshin" ose "të tilla si" do të interpretohen sikur nënkuptojnë "përfshin pa kufizim " dhe "të tilla si pa kufizim ", sipas rastit.

30. Bashkimi i Marrëveshjeve. Për të garantuar: (a) kushtet konsistente zbatohen në Programin BlackBerry PC, Programin BlackBerry të Serverit dhe Programin e BlackBerry HandHeld, kur secili përdoret si pjesë e tuajit BlackBerry Solution; dhe b) qartësi për sa i përket se cilat kushte të licensës aplikohen tek Programi BlackBerry Handheld, kur përdoret si pjesë e BlackBerry Solution Tuaj, pavarësisht mënyrës se si e keni përftuar atë Program BlackBerry Handheld, DUKE PRANUAR KUSHTET E KESAJ MARRËVESHJE NË MENYREN E PËRSHKRUAR ME SIPËR, JU GJITHASHTU BINI DAKORT QË: I) KJO MARRËVESHJE ZËVENDËSON DHE SHFUQIZON MARRËVESHJET E MËPARSHME EKZISTUESE PËR LIÇENSËN E PROGRAMIT BLACKBERRY TË PËRDORUESIT FUNDOR DHE MARRËVESHJEN E LIÇENSIMIT TË PROGRAMIT TË SERVERIT BLACKBERRY ENTERPRISE, ÇDO MARRËVESHJEN TJETËR TË MËPARSHME EKZISTUESE PËR LIÇENSËN E PROGRAMIT BLACKBERRY OSE MARRËVESHJE LICENSIMI BLACKBERRY SOLUTION, DHE ÇDO MARRËVESHJE SHËRBIMI BLACKBERRY PROSUMER, ME JU PËR PROGRAMIN OSE SHËRBIMET RIM; DHE II) KY VERISION I BBSLA ZËVENDËSON SHITESAT DHE KUSHTET SHITESË QË VIJOJNË: BLACKBERRY APP ËORLD DHE SHITESA E SHËRBIMIT TË PAGESËS BLACKBERRY, KUSHTET DHE AFATET E IDENTIFIKIMIT TË BLACKBERRY, SHITESA BBM MUZIK, SHITESA BLACKBERRY PROTECT, SHITESA BLACKBERRY TRAVEL, KUSHTET SHITESË TË PROGRAMIT VIDEO CHAT, KUSHTET SHITESË TË PROGRAMIT BLACKBERRY MESSENGER, NË ÇDO RAST VETËM PËR AQ SA KËTO MARRËVESHJE DHE SHITESA JANË TË APLIKUESHME, QË NGA DATA E PRANIMIT TË KËSAJ MARRËVESHJEJE, PËR ÇDO PROGRAM QË BËN PJESË E TUAJIT BLACKBERRY SOLUTION.

Të gjitha referencat lidhur me Liçensën e Programit BlackBerry të Përdoruesit Fundor, Marrëveshjen e Liçensimit të Programit të Serverit të BlackBerry Enterprise, Marrëveshjet e Liçensimit të Programit BlackBerry, Marrëveshjen e Liçensimit të BlackBerry Solution në Marrëveshje, shtesa, ose dokumentacione të tjera që Ju keni me RIM për BlackBerry Solution Tuaj, do të konsiderohen si referenca të kësaj Marrëveshje për Liçensimin e BlackBerry Solution Tuaj (përveç për aq sa, këto referenca nuk do të kishin kuptim në përmbajtje, p.sh. ku, si në këtë dispozitë, nëse ka një dallim midis marrëveshjeve të mëparshme ekzistuese dhe Marrëveshjeve për Liçensimin e Programit BlackBerry, referencat në marrëveshjet e mëparshme ekzistuese nuk do të konsiderohen si referenca të Marrëveshjeve të Liçensimit për Programin BlackBerry).

Çdo ndryshim ose shtesë në Marrëveshjet e mëparshme ekzistuese për Liçensën e Programit BlackBerry të Përdoruesit Fundor ose Marrëveshjet e Liçensimit të Programit BlackBerry Enterprise ose Marrëveshjet e Liçensimit të Programit BlackBerry ose Marrëveshja e Liçensimit të BlackBerry Solution në bazë të së cilave Ju u pajiset me programin nga RIM, do të konsiderohen si ndryshime ose shtesa për këtë Marrëveshje.

NË SE KENI NDONJË PYETJE OSE SHQETËSIM NË LIDHJE ME KUSHTET E KËSAJ MARRËVESHJEJE, JENI TË LUTUR TË KONTAKTONI RIM NË [legalinfo@rim.com](mailto:legalinfo@rim.com).